

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 12(437)

DHJETOR 2024

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## PËRSHËNDETJA



**FLAMURI SHQIPTAR VALËVITET KRENAR KRAH FITIMTARËVE TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

**Tatjana PARLLAKU – ÇARKAXHIU**  
Kryetare e OBVLP

**FAQE 2**

## REFLEKSIONE

**SI E KUJTOJ UNË GJENERAL PARLLAKUN**



**Genci BALLANCA**

**FAQE 2**

## ME PROPOZIMIN E OBVLP



**KRYEBASHKIAKU VELIAJ: "ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE" PËR VETERANIN SHUAIP METHASANI**

**Nga Halil RAMA**

**FAQE 9**

*OBVLP dhe LID përkujtojnë "Nderin e Kombit" Dali Ndreu, me prejardhje nga një familje tradicionale atdhetare e patriotike dibrane shqiptare*

# DALI NDREU E KA DREJTUAR LANÇ SI OFICER KARRIERE

## TË THJESHTAT DERI NË MADHËSHTI...

(Për nënat e dëshmorëve)

**Namik Dokle\***

**N**ga të gjitha mrekullitë e botës, qofshin shtatë apo shtatëdhjetë, e para dhe më e madhja është NËNA. Edhe vetë jeta nuk ka ardhur dhe as mund të vinte pa ekzistencën e nënës.

**VIJON NE FAQEN 3**



*Të dënohej e pushkatohej Dali Ndreu si armik e për tentativë arratisjeje, me siguri, ka qenë një alibi e sajuar nga një segment i Beogradit që është shpërblyer prej tyre. Nuk mund të arratiset Dali Ndreu në Beograd, sepse nuk mund të mirëpritej prej tyre për bëmat antiserbe të gjyshit të tij, Elez Isuf Ndreut*

**Tefta Cami-Cani**

**FAQE 4**

AKADEMIA PËRKUJTIMORE

**Dali Ndreu, komandant i njësisve të mëdha strategjike**

**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**

**FAQE 5**

## NDERIMI



**HALIL RAMA DHE SKËNDER MURRJA "QYTETAR NDERI" TË BULQIZËS**

*Këshilli Bashkiak vlerëson gazetarin e shkrimtarin e mirënjohur dhe mësuesin veteran shembullor*

**Nga TRIFON LLUPO**

**FAQE 8**

## 80-VJETORI


**OVLANÇ E KOSOVËS, VEPRIMTARI PËRKUJTIMORE NË GJAKOVË, PRIZREN E PRISHTINË**

**Bashkim HISARI**

**FAQE 10**

## PROFILI

**SELMAN AHMETI, LUFTOI TRIMËRISHT KUNDRA PUSHTUESVE SERBË E NAZIFASHISTË**



**Nga**

**Muharrem GJOKA**

*Mjeshtër i Madh & Nënkrjetar i OBVLP*

**FAQE 7**

## HISTORIA

**BATALIONI PARTIZAN PUKA NË 80-VJETORIN E KRIJIMIT**

**Xhemal Meçi**

*"Mjeshtër i Madh" & Studiues*

**FAQE 11**

## EKSPOZITA

**PËRMET- EKSPOZITË ME FOTO DHE SKICA TË EDITH DURHAM**

**Muharem Kamani**

**FAQE 12**

## SUPLEMENTI LETRAT

**MESAZHE ATDHETARIE NGA ROMANI "KALORËSI I SKËNDERBEUT" I HAKI STËRMILLIT**

**Beqir Ajet Shehu...fq. 6**

**FAJI ËSHTË I URDHËRUESIT TË LUFTRAVE**

**Tregim nga Sakip Cami...fq.15**

**SOLLZHENJICINI, SHKRIMTARI QË I DEMASKOI MË SHUMË SE KUSHDO KRIMET KOMUNISTE**

**SHPËNDI TOPOLLAJ...fq.13**

**KADRI TARELLI VETERAN I FJALËS**

**MEVLUD BUCI...fq.14**

## PËRSHËNDËTJA

## 80-VJETORI I ÇLIRIMIT TË ATDHEUT NGA PUSHTUESIT NAZIFASHISTË

# Flamuri Shqiptar valëvitet krenar krah fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore

Tatjana PARLLAKU – ÇARKAXHIU

Kryetare e OBVL

Ë shtë kënaqësi e veçantë për Veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe për ne pasardhësit e tyre, që në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Atdeut nga okupatori nazifashist të përulemi me respekt përpara familjeve të dëshmorëve të atdeut dhe të kujtojmë dëshmorët e kombit, bijtë dhe bijat e Shqipërisë që në lulen e rinisë dhanë gjakun e tyre për çlirimin e Atdeut.

Fitore e madhe ishte çlirimi i Tiranës por kjo erdhi pas 5 Prillit 1944 kur Shtabi i Përgjithshëm urdhëroi mësymje të të gjithë forcave partizane kundër okupatorit nazist. Forcat partizane të Korçës çliruan Bilishtin, Ersekën dhe Pogradecin. Bigada e I-rë zhvilloi luftime të ashpra në Qukës, Krrabë dhe çliroi



• *Shqipëria vlerësohet si i vetmi vend në botë që me pak ndihma nga aleatët zhvilloi luftime të ashpra dhe korri fitore me gjakun e të rinjve dëshmorë të atdeut, t vetëm me forcat e veta pa ndihmën e askujt*

Lufta për çlirimin e Tiranës i parapriu çlirimit të plotë të vendit. Ajo u zhvillua e ashpër për 19 ditë rresht në çdo rrugë e shtëpi ku i gjithë populli i kryeqytetit i madh dhe i vogël u ngrit në këmbë kundër ushtrisë gjermane. Në luftime mbetën të vrarë 127 partizanë dhe u plagosën 290 të tjerë.

Nga gjermanët u vranë 3000 vetë dhe u plagosën shumë të tjerë. Brigada e I-rë luftonte me ashpërsi në qendër të Tiranës dhe kishte marrë në zotërim Sahatin e Tiranës, Shtëpinë e Oficerëve dhe Teatrin.

(Vijon në faqen 3)



Elbasanin. Brigada e V dhe e VI çliruan Himarën, Mallakastrën, Gjirokastrën, Delvinën, Sarandën, Konispolin, Vlorën dhe Fierin.

## Si e kujtoj unë gjeneral Parllakun

Genci BALLANCA

N ë jetë njeriut i takon të njohë e miqësohet me disa persona. Gjithësi, janë të paktë ata që të mbeten në mendje e kujtesë.

Për mua që po i afrohem një shekulli jetë, i tillë ka mbetur Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, gjenerali legjendar Rrahman Parllaku. Si pjesëmarrës aktiv në Brigadën e IV- Sulmuese, por edhe gjatë gjithë jetës time kam patur dhe kam respekt dhe nderim maksimal për këtë burrë të rrallë shteti. Në moshën që jam, më bëhet zemra mal kur dëgjoj që OBVL që ai e drejtoi me përkushtim të rrallë, vazhdon misionin e saj të edukimit patriotik të brezave, pikërisht sipas përvojës dhe mësimëve të gjeneral Parllakut.

Veçanërisht vlerësoj Akademinë Përkujtimore që OBVL organizoi në 105-vjeëtorin e lindjes së gjeneralit që bëri epokë.

Pata fatin që si ish kryetar i Degës së OBVL Durrës për afro dy dekada, të bashkëpunoja ngushtë dhe ta njihja nga afër këtë personalitet të rrallë që ka

hyrë dhe qëndron me ndinjtet në panteonin e vlerave tona kombëtare. Me mbështetjen e tij si kryetar i OBVL arritëm të vlerësojmë disa personalitete, me medalje e tituj "Qytetar Nderi" të Durrësit, madje edhe ti vendosnin një rrugë emrin "Nako Spiro".

Në udhëtimin e tij shekullor, Gjeneral Parllaku, jetoi luftën dhe paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm, duke sfiduar kohët dhe regjimet, me përkushtim ndaj kombit, trimërinë dhe urtësinë e malësorit, shpirtin e lirisë dhe atdhedashurisë, duke mbetur i pathyer në çdo betejë që zgjodhi dhe iu imponua përgjatë 100 viteve që ai jetoi.

Kështu do ta kujtoj sat ë kem jetën Nderin e Kombit Rrahman Parllaku, si një nga figurat emblematiche të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, dhe që mbeti si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Kam bindjen se shqiptarët ndjehen krenarë me jetën dhe veprën e "Heroit të Popullit" dhe "Nderit të Kombit", që bëri gjithçka në shërbim



të atdeut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë.

## FJALA

## TË THJESHTAT DERI NË MADHËSHTI...

(Për nënat e dëshmorëve)

Namik Dokle\*

**N**ga të gjitha mrekullitë e botës, qofshin shtatë apo shtatëdhjetë, e para dhe më e madhja është NËNA. Edhe vetë jeta nuk ka ardhur dhe as mund të vinte pa ekzistencën e nënës. Deri më sot, të paktën, asnjë gjuhë e botës nuk ka mundur të shprehë plotësisht forcën, bukurinë, shpirtmadhësinë dhe heroicitetin e nënave. Prandaj thuhet në këtë botë tonë se Perëndia, duke mos mundur të ishte kudo dhe në çdo moment, krijoi NËNËN. Zemra e saj është ai lloj kapitali që kurrë nuk falimenton dhe tek i cili, gjithkush prej nesh, mund të mbështetet me siguri të plotë sa të ketë jetë.

Në këto ditë, kur po afron Festa e çlirimit të Shqipërisë, kujtojmë njëzetetë mijë dëshmorët që dhanë jetën për lirinë e saj, liri të cilën e gëzojmë që prej tetëdhjetë vjetësh. Por kurrë nuk kemi harruar dhe as nuk duhet të harrojmë se ata i kishin lindur njëzetetë mijë nëna, nuk kemi harruar dhe nuk harrojmë se prapa emrit të një trimi a të një heroi, qëndron një nënë trimëshë dhe një nënë heroinë. Dëshmorët tanë janë yje të lirisë, janë yje që nuk shuhet, por edhe nënat janë yjet që më shumë ndriçojnë.

Gjatë jetës dhe punës time më ka rastisur të shkojë në shumë familje dëshmorësh, të takoj plot nëna të tyre, ato nëna që i kishin lindur bijtë dhe bijat për "një botë të re", siç këndohej dikur. Është i paharrueshëm për mua zëri i nënës së Misto Mames, i qetë dhe i thellë, sikur po dilte nga vargmalet dhe grykat e historisë. Dhe po më tregonte gjënë më njerëzore, çfarë i kishte dhënë të birit për të ngrënë për mëngjesin e fundit që e përçollti, drejt pavdekësisë. "Ja, këtë etazher për libra e ka bërë Mistua, me duart e tija; edhe këtë gozhdën që është pak e dalë,



ashtu e kam lënë gjithë këto vite, ashtu si e la vetë ai. Aty, mes librave, është edhe vjersha që Mistua shkroi për Mihal Durin, që u vra 6 ditë para tij..." Dy shokë, dy heronj, dhe një nënë që nuk i ndan, por flet për ta si t'i kishte të dy djemtë e saj.

Nuk mund të harrohet nëna labe Shahe Luçi, që i ngriti këngë Jasharit, djalit të saj dëshmor:

Erdha dhe t'u qasa pranë,  
Me thonj ta zbulova varrë,  
Më zuri dora në ballë,  
Aty ku kishe marrë plagë...

Pas luftës, edhe djali i dytë i saj, Nuriu, ra dëshmor. Dhe kjo nënë heroinë, thuri këngën e famshme për të dy:

O djem, ç'bëni kështu?  
Vitet tutje, ju tëhu...

Nuk mund të harrohet as nëna e dëshmores kukësiene Hava Kërkhaliu, që bashkë me të bijën endën në qilimin e nusërisë shqiponjën e flamurit dhe gerat "V.F."—"L.P."

Më ka surprizuar nëna e heroinës mirditore Dila Marku, kur e pyeta për fjalën e fundit të së bijës...: "Oj, nanë, ma jep një pikë ujë! Por nuk ia dhashë dot, nuk më lanë kriminelët..." Ramize Gjebrea, një natë para pushkatimit, qëndroi në një familje të panjohur, me një nënë të panjohur. Në mëngjes, edhe pse e dinte që po e çonin drejt pushkatimit atë partizane të re, i dha një palë çorape. "Merri, bijë, i tha, mos të të mardhin këmbët." Dhe e qau "me ligje, sikur ta kishte bijë të vetën. Kështu ishin nënat shqiptare, në ato humnera të historisë, kur rrezikohej vendi, kur ishte skllavëruar populli, kur liria ishte në thikë e në brisk. Sa të thjeshta, po aq madhështore; sa të varfëra, po aq shpirtpasura; sa të brishta, po aq të papërkulura; sa të dhembësura, po aq trimëshë! Ato treguan atë forcë të jashtëzakonshme, që kapërcen edhe ligjet e natyrës, gjë që vështirë ta bëjë ndonjë qënie tjetër kesisoj. Ato i mësuan bijtë e tyre se është e vështirë të triumfosh në një luftë të pabarabartë, në një luftë me armiq të egër dhe dimra të acartë, por nuk është e pamundur. Kurajo nënash! E pakrahasueshme! E paarritshme! Është e tillë sepse nënat janë ai tip martiri që e japin pak e nga pak jetën e tyre për të tjerët, për bijtë e vet dhe për bijtë e nënave të tjera.

Sot nuk janë më mes nesh nënat e dëshmorëve. Shkuan njera pas tjetrës atje ku prehen djemtë dhe vajzat e tyre. Me një mall dhe me një brengë, me një fjalë a me një këngë, duke na lënë një amanet: "Mos i harroni vajzat dhe djemtë e lirisë! Ata i dhanë atdheut gjënë më të shtrenjtë që ka njeriu dhe nuk kanë asnjë faj për çka u bë dhe nuk u bë me Shqipërinë, pas sakrificës së tyre."

\*Mbajtur në takimin "Shqipëria e Dëshmorëve", organizuar nga Bashkia Tiranë dhe Organizata Kombëtare për dëshmorët e LANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut, në Hotel Tirana International më 20 Nëntor 2024.

## Flamuri Shqiptar valëvitet krenar krah fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore

(Vijon nga faqja 2)

Brigada e VIII-të, zhvillonte luftime në Rugën e Kavajës, kurse forcat gjermane mbanin nën kontroll godinat e ministrive, Bankën, Bashkinë dhe Hotel London që ndodhej ku ndodhet sot Muzeu Historik Kombëtar. Në datë 16 shtator 1944 të mposhtur përfundimisht nga lufta në Kryeqytet, gjermanët i grumbulluan forcat e tyre pranë Fushës së Avacionit dhe në të aguar të 17 Nëntorit u nisën drejt qytetit të Shkodrës. Gjatë rrugës u goditën nga forcat partizane në Vorë dhe Lezhë dhe më pas u drejtuan në Shkodër, një qytet me vlera të lashta historike dhe një qendër e rëndësishme social-ekonomike e vendit, çlirimi i të cilës do të vulooste dhe çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Në Shkodër u grumbulluan rreth 3000-4000 forca gjermane dhe rreth 2500 bashkëpunëtorë të tyre që iu bashkëngjitën autokolonës gjermane drejt frontit të perëndimit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë dhe popullsinë e Kosovës dhe trojeve etnike shqiptare në Mal të Zi dhe Maqedoni rrezikonin shpërnguljen e tyre pasi Konferenca e të Mëdhenjve e kryesuar nga Çurçill, Stalini dhe Ruzvelti kishin vendosur që shtetet të cilat do të përkrahnin nazistët do të shpërnguleheshin nga trojet e tyre dhe mund të asimiloheshin nga shtetet fitimtare të luftës. Prandaj Shtabi i Përgjithshëm ju vuri si detyrë që Divizioni i I-rë dhe më konkretisht Brigada e III-të dhe e V-të pas çlirimit të Matit, Lumës dhe Dibrës detyrë kryesore do të kishin çlirimin e Kosovës dhe konkretisht të goditeshin forcat naziste, rinia kosovare të merrte pjesë masivisht në luftë dhe të ngriheshin këshillat nacional çlirimtare në zonat e çliruara.

Brigada e III-të dhe e V-të pas çlirimit të Tropojës

çliruan Prizrenin, Gjakovën dhe Pejëën duke hasur në rrezistencën e ashpër të Divizionit gjerman SS Skënderbej.

Kështu dështuan planet e ideologut shovinist serb Vasa Çubrolloviç për spastrimin etnik të shqipëtarëve.

Shqiptarët e Kosovës me 55 mijë djem e vajza që luftuan heroikisht kundër nazizmit vulosën fitoren në trojet tyre duke mos pasur fatin e Rumanisë që iu shkëput Republika e Moldavisë si dhe fatin e 10 milion gjermanëve që u shkëputën nga Prusia, Krakovia etj.

Populli shqiptar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi është krenar që iu bashkua Aleancës Antifashiste të popujve dhe çliruan vendin e tyre pa ndërhyrjen e forcave aleate.

Partizanët trima shqipëtarë kishin përballuar operacionin e egër të dimrit 1943-1944 dhe përballuan krah vëllezërve Kosovarë edhe operacionet e vështira të dimrit të egër në Sanxhak e Bosnje.

Flamuri Shqiptar valëvitet krenar krah fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore. Në analizat mbi fitoren, Populli shqiptar ishte i vetmi që çliroi vendin e tij pa ndihmën e forcave aleate.

Bashkimi Sovjetik ndihmoi në çlirimin e të gjitha vendeve të lindjes dhe me hapjen e frontit të dytë të Luftës së Dytë Botërore për çlirimin nga nazistët vepronin forcat anglo-amerikane. Shqipëria vlerësohet si i vetmi vend në botë që me pak ndihma nga aleatët zhvilloi luftime të ashpra dhe korri fitore me gjakun e të rinjve dëshmorë të atdheut, vetëm me forcat e veta pa ndihmën e askujt.

Duke u përkulur me respekt përpara dëshmorëve të atdheut, atyre të rinjve idealist që dhanë gjakun dhe jetën e tyre në lulen e rinisë s'na mbetet gjë tjetër veç se të themi: Lavdi Dëshmorëve të Kombit dhe i përjetshëm qoftë kujtimi i tyre.



## AKADEMIA PËRKUJTIMORE

# Dali Ndreu e ka drejtuar LANÇ si oficer karriere



**OBVLP dhe LID përkujtojnë "Nderin e Kombit" Dali Ndreu, me prejardhje nga një familje tradicionale atdhetare e patriotike dibrane shqiptare**



me 10 korrik 1943 me komandant Spiro Moisiun e pas disa muajve Enver Hoxha.

Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë, që udhëhoqi Fronti Nacional Çlirimtarë ka qenë një ndër Lufrat e mëdha të popullit shqiptarë, që u çliroam nga vetë shqiptarët, që u lidhëm me fitimtarët e aleatë të mëdhenj si BS, SHBA dhe Britania e Madhe. Prandaj Lufta Çlirimtare duhet përkujtuar me Nderime e respektin ndaj luftëtarëve të lirisë, ndaj 24 mijë dëshmorëve që luftuan me heroizëm e derdhën gjakun për çlirimin e mëmëdheut. Në situatat aktuale ku ka disa vatra lufte në botë, ku Serbia po përgatitet për Luftës kundër Kosovës, na duhet të jemi vigilentë e të përgatitur për te mbrojtur trojet tona, Shqipërinë e Kosovën!

Dali Ndreu ka drejtuar luftën si oficer karriere dhe më vonë ka fituar gradën gjeneral. Të dënohej e pushkatohej

## Tefta Cami-Cani

- **Të dënohej e pushkatohej Dali Ndreu si armik e për tentativë arratisjeje, me siguri, ka qenë një alibi e sajuar nga një segment i Beogradit që është shpërblyer prej tyre. Nuk mund të arratiset Dali Ndreu në Beograd, sepse nuk mund të mirëpritej prej tyre për bëmat antiserbe të gjyshit të tij, Elez Isuf Ndreut**



Ndreut, Lavdien e nipin e tij, Enverin, të cilët përjetuan vitet e persekutimit në sistemin e kaluar.

Familja e Ndrejeve të Sllovës kanë qenë të lidhur dhe kanë bashkëpunuar me paraardhësit e mij Cami, si dhe me të tjerë gjatë gjithë periudhave të historisë në lufrat kundër pushtuesve të huaj për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Gjatë Luftës së Parë Botërore 1913-1918 në krahinat Veri-Lindore të Shqipërisë në Luftën kundër sulmeve të forcave pushtuesve serbe e bullgare ishte krijuar një kordon i madh lufte e bashkëpunimi qëndresë të papërkulur nga Luma me Muharrem Bajraktarin, me princin e paepur Elez Isuf Ndreun në Sllovë, me Aliajt në Fushë Alie, me Karasanët e Shehelerët në Peshkopi, me Ismail Strazimirin e bejleret e Maqellarës në Maqellarë, me Mersim Demën në zonën e Shpenzës, me Fet, Shaban dhe Dan Camin në zonën Tërbaç e Gollobordë, me Aqif pash Elbasanin në zonën Librazhd-Pogradec, me Starovët në Pogradec-Korçë dhe me Sali Butkën në zonën Korçë-Leskovik. Këto familje të mëdha tradicionale i bashkonte besa e ideali kombëtarë, për të mbrojtur interesat kombëtare. Gjatë Luftës së Parë Botërore është vrarë e ma-



sakruar nga forcat serbe Fet Shaban Cami, si legjenda e asaj lufte në atë krahinë dhe vritet nga forcat pushtuese bullgare Shaban Mahmut Cami, sipas botimit të ASHSH me autor Gazmend Shpuza në librin me titull "Mbi Lëvizjen fshatare e Shqipërisë të Mesme". Edhe në Luftën e Dytë Botërore kundër pushtuesve fashist italianë e nazistëve gjermanë u ngritën e luftuan djemtë e burrat e familjeve tradicionale patriote, që organizuan qëndresën e rezistencën në krahinë, krijuan çeta, sipas traditave të Maleve të Dibrës. Mbi këtë traditë krijoi Çetë edhe Ahmet Fet Cami që në janar të vitit 1940 dhe bëri dy aksione në fund të marsit dhe me 2-3 prill 1941 për sigurimin e armëve e municioneve për çetën. Prandaj futen në pushkatim 8 vetë (7 Cami) dhe në burg 19 burra e djem Cami me Ahmet Camin

si organizator. Në pushkatim pushkatohen Ejup Shahin Cami, Musa Rahman Cami dhe Mexhit Lezi nga Luznia. Emrat e të arrestuarve e të pushkatuarve janë në Fondin e MPB të atyre viteve dhe në Ditarin e burgut të Ahmet Fet Camit 1941-1942 të burgosur si antifashistë.

Çeta e Ahmet Camit ka bashkëpunuar me Çetën e Sllovës e të Grykës së Madhe dhe të Martaneshit që



në vitin 1941, kur janë krijuar ato. Ahmet Cami ka qenë ngarkuar nga dy të deleguarit e KQ të PK, Zoi Themeli e Njazi Islami dhe ka organizuar krijimin e Batalionit Partizan të Dibrës me 26 korrik 1943 ne fshatin Gjoricë, ku Camet ishin të kosiderueshëm. Fashli Fet Cami vritet me 7 prill 1941, Ahmet Fet Cami vritet ne Luftën për mbrojtjen e qytetit të Peshkopise në tetor 1943 nga forcat prej 45 vetë të një çete serbo-malazeze brenda kufirit të Shqipërisë. U vranë e dhe 12 burra e djem Cami. Lëvizja antifashiste në Dibër është organizuar nga dibranët brenda Shqipërisë e jo nga misionarët e ardhur nga Beogradi, siç është shruar e vazhdojnë të shkruajnë ende disa të influencuar prej tyre.

Dali Ndreu ka qenë zgjedhur z/komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacional Çlirimtare

Dali Ndreu si armik e për tentativë arratisjeje, me siguri, ka qenë një alibi e sajuar nga një segment i Beogradit që është shpërblyer prej tyre. Nuk mund të arratiset Dali Ndreu në Beograd, sepse nuk mund të mirëpritej prej tyre për bëmat antiserbe të gjyshit të tij, Elez Isuf Ndreut. Ai ishte i informuar, se Cen Elez Ndreu, që shkoi pas çlirimit në Beograd, ndërroi jetë nga torturat e dhuna e serbëve. Kjo mund të shpjegohet edhe për kryeministrin Mehmet Shehu, që në vitin 1947 ishte përjashtuar nga partia si antijugosllav dhe me kthesën e PK në vitin 1948 rikthehet në parti, që u akuzua si agjent i tyre. Edhe për të kjo akuzë ka qenë një farsë nga segmente të Beogradit, për të akuzuar e njollosur figurat e shquara patriotike shqiptare.

**Tiranë, e premte, 15 nëntor, 2024**

## AKADEMIA PËRKUJTIMORE

# DALI NDREU, komandant i njësive të mëdha strategjike

**Prof. Asoc. Dr.  
Bernard Zotaj  
Mjeshtër i Madh**



operative e luftës së armatosur. Plotësimi i këtyre detyrave e mundësonte arrijen e objektivave strategjike të saj, duke respektuar ligjet dhe rregullat e luftës. Në proklamata e evidentohen goditjet dërrmuese që kishin marrë hordhitë hitleriane nga aleatet; sidomos në betejën e Stalingradit dhe fitoret e bujshme të arritura nga forcat anglo-amerikane në Afrikën e Veriut e në Sicili. Një situatë e tillë, jo vetëm favorizonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popujve që luftonin kundër zgjedhës nazi-fashiste, por njëherazi kërkonte fuqizimin e mëtejshëm të luftës së tyre të armatosur.

Në këto rrethana krijimi i Shtabit të Përgjithshëm merrte rëndësi të veçantë edhe në planin ndërkombehtar se Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare, si pjesë përbërëse e luftës së madhe antifashiste botërore, nuk mund të bashkërendohej si duhej me luftën e shteteve e të popujve pjesëtarë të kualicionit botëror antifash-

ist pa një shtab drejtues të posaçëm në shkallë kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm do të mund të realizonte një koordinim më të mirë e më të plotë të luftës së popullit tonë në kuadrin e teatrit luftarak të Mesdheut, si edhe me luftën e popujve fqinjë të Ballkanit. Po kështu veprimtaria e Shtabit të Përgjithshëm krijonte kushte për një vlerësim më real të luftës së armatosur të popullit shqiptar.

Ideja për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u hodh që në Konferencën e Pezës. Në praktikë kjo ide u realizua afër një viti më vonë. A mund të ishte krijuar ky shtab më parë? Analiza tregon se krijimi i këtij Shtabi ishte rrjedhojë logjike e ndryshimeve të rëndësishme sasiore e cilësore që kishin ndodhur në formacionet partizane dhe në veprimtarinë luftarake të tyre. Një organizim i tillë i një rëndësie të veçantë s'mund të jetë produkt i dëshirës subjektive. Shtabi i Përgjithshëm nuk mund të ishte një



krijesë artificiale. Formimi i tij presupozonte një shkallë të luftës së armatosur e të formacioneve partizane që erdhi natyrshëm kur ishin pjekur kushtet.

Shtabi i Përgjithshëm ishte organi më i lartë i udhëheqjes politike e ushtarake të UNÇSH-së. Me krijimin e tij, lufta e armatosur e popullit shqiptar hyri në një etapë të re zhvillimi, në atë të kryengritjes së përgjithshme popullore. Ajo mori karakter më të organizuar, më të gjërë e më të ashpër. Udhëheqja strategjike e Forcave të Armatosura kundër fashiste u ngrit në një shkallë më të lartë e më të specializuar. Ndaj dhe zgjedhja e anëtarit të shtabit, Dali Ndreu u bë mbi bazën e meritave dhe të aftësive luftarake e drejtuese, të përvojës ushtarake dhe të traditave patriotike dhe luftarake të familjes në shekuj.

Dali Ndreu vinte nga familje e shquar atdhetare e Dibrës. Fëmijëria e Daliut, përkon me periudhën e viteve 1912-1924 dhe kalon në mjedis luftarak. Familja e Ndrejeve, ku shquhej xhaxhai i Daliut, patrioti dhe prijësi i madh popullor Elez Isufi, ishte përfshirë tërësisht në ngjarjet më të mëdha në ruajtjen e kufijve të vendit, konsolidimin dhe demokratizimin e shtetit të ri shqiptar. Në këtë mjedis patriotik që la mbresa të pashlyeshme e po brumosej djaloshti Dali me ndjenjën e atdhedashurisë, të trimërisë e të urrejtjes për armiqtë e Shqipërisë. Dali Ndreu në vitin 1931, në moshën 19 vjeçare, përfun-

don shkollën e plotësimi të Tiranë, në degën e Artilerisë dhe titullohet oficer me gradën ushtarake nëntoger. Ai ishte pjesëmarrës në lëvizjen antizogiste të Fierit, ku pas dështimit të saj, u arrestua dhe humbi të drejtat e gradës ushtarake. Mbas daljes nga burgu, Dali Ndreu, i dhënë dhe i etur për kulturë, ndoqi studimet e larta në Firence të Italisë, në shkencat ekonomike, duke fituar kështu formim të gjërë dhe të shëndoshë intelektual.

Pushtimi fashist i vendit nuk e lejoi t'i përfundonte studimet. Atdheu e thërret dhe Daliu kthehet, duke zënë vendin e nderit në barrikadën e luftëtarëve të vendosur antifashiste. Aktivizohet gjerësisht në luftë dhe në genin e familjes së madhe e fisnike të Ndrejeve, merr pjesë në njësitet luftarake të zonës së Dibrës. Në pranverën e vitit 1942 zgjidhet komandant i çetës partizane të Slllovës në Dibër. Emri i tij ishte i dëgjuar në zonën e Dibrës, por kishte arritur deri në Pezë, tek Myslim Peza që ishte antifashisti i parë në Shqipëri.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë anëtar i tij, dhe si një ushtarak i përgatitur u shqua dhe u dallua për një veprimtari intensive. Me njohuri të thella në fushën ushtarake, me aftësitë e tij komunikuese, organizuese e drejtuese dhe largpamësinë në gjykimin e situatave, Dali Ndreu ishte dhe ka mbetur një ndër figurat më të kompletuara të

(Vijon në faqen )

## HISTORIA

Shkrimtari patriot Haki Stërmilli, një jetë në shërbim të Atdheut e Kombit shqiptar

# Mesazhe atdhetarie nga romani “Kalorësi i Skënderbeut”



Beqir Ajet Shehu\*

Në historinë e letërsisë shqiptare, Haki Stërmilli përfaqëson shkrimtarin demokrat, jeta dhe veprimtaria e të cilit u lidh ngushtë me fatet e atdheut dhe të luftës së forcave patriotike e revolucionare për një Shqipëri të lirë, të bashkuar dhe të përparuar. Haki Stërmilli përjetoi pasojat e ngjarjeve më dramatike në historinë e popullit shqiptar e në veçanti të Dibrës, vendlindjes së tij. Traditat patriotike dhe jeta e pasur zakonore në vendlindjen e tij, atmosfera që krijuan në Dibër zhvillimet e vullshme të lëvizjes patriotike të atdhetarëve të shquar dibranë Hoxh Voka, Dervish Hima, Josif Bageri e të tjerë, si dhe rënja e Dibrës nën robërinë e pushtuesve sërbë dhe pasojat e tmerrshme që i sollën vendit, masakrat shtazore mbi popullsinë e pafajshme, qenë atmosfera ku i riu Haki Stërmilli, u rrit u shkollua dhe u formua për të marrë përsipër detyrën e vështirë të dalzotësit ndaj vendit e njerëzve të tij.


Sapo mbaroi gjimnazin në Manastir, ku qe dërguar me ndihmën e interesimin e patriotit Dervish Hima, bëhet një prej drejtuesve kryesorë të shoqërisë “Djelmënia Dibrane” e cila zhvilloi një veprimtari të guximshme patriotike mes vëllezërve të vendlindjes.

Pas Kongresit të Lushnjës, Haki Stërmilli vendoset në Tiranë, në administratën e shtetit të ri dhe merr anën e lëvizjes rinore përparimtare në luftën e ashpër mes forcave politike që zhvillohej në atë kohë. Haki Stërmilli u bë një nga militantët më të shquar të lëvizjes demokratike të rinisë dhe si drejtues i shoqërisë “Bashkimi”, mori pjesë me armë në dorë në ngjarjet e Revolucionit të Qershorit 1924, për të sjellë në fuqi një qeveri demokratike. Pas rënies së qeverisë së Fan Nolit, Haki Stërmilli, si shumë patriotë demokratë, u detyrua të emigronte në disa shtete të Europës e duke qenë edhe anëtar i “KONARE-së”, nuk e ndërpreu asnjëherë veprimtarinë e tij patriotike revolucionare në interes të atdheut e kombit.

Në vitin 1929, me ndërhyrjen e Ahmet Zogut, qeveria jugosllave ktheu në Tiranë Haki Stërmillin dhe Zogu e burgosi, duke mos marrë në konsideratë as protestën e “KONARE-s”, të nënshkruar edhe nga personalitete, si shkrimtari Henri Barbys, fizikati Ajnshtajn, Sen Katajama e shumë deputetë e profesorë nga të katër anët e botës.

## E VËRTETA E DITËS SË ÇLIRIMIT NË DITARIN E HAKI STËRMILLIT

Pushtimin fashist të vendit, të cilin e kishte parashikuar në një artikull të botuar në gazetën “Liria Kombëtare”, Haki Stërmilli e priti me shumë trishtim. “Okupacioni fashist - shkruan ai - më egërsoi tepër. ...Deri në Konferencën e Pezës punova ashtu si ma muer mendja se mund t'i shërbej-



sha popullit e atdheut. Mbas Konferencës u rrjeshtova në Kampin e Frontit Nacional Çlirimtar”. Dhe ashtu veptoi. Megjithëse e kishte kaluar moshën e veprimeve të guximshme, në verën e vitit 1943 u hodh në radhët e luftës partizane duke përballuar vështirësi, rreziqe e beteja deri në ditën e çlirimit të vendit. Dhe ja çfarë shkruan në ditarin e tij më 28 nëntor 1944 luftëtari i shquar, shkrimtari demokrat, Haki Stërmilli: “Në këtë ditë feste, dy herë historike, sytë e zemrave të popullit tonë drejtohen kah vorret e mija, të dëshmorve që siguruan fitoren, dhe me gjakun e tyre të pastër shkruen një epike të madhnueshme”. Pasi përshkruan aktivitetet e kësaj dite, dy herë historike, duke filluar që nga ora 10’30, me daljen e Komandantit Enver Hoxha me Qeverinë Demokratike, ku nga trbuna e ngritur para Hotel Dajtit, përshëndeti parakalimin e 15 mijë djemve e vajzave të brigadave partizane”, ditarin e kësaj ditë feste, dy herë historike, e përfundon me fjalinë “Festa vazhdon”.

Citova fletë ditarin e kësaj dite dy herë historike pasqyruar në “Ditarin Partizan” të Haki Stërmillit, për dy arsye.

Së pari, se e gjithë veprimtaria e tij, si shkrimtar dhe si luftëtar me armë në dorë, lidhet me këto dy sihariqe: Shpalljen e Pavarësisë dhe Çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashist..

Së dyti, kremtimi i 28 nëntorit 1944, si “ditë dy herë historike”- dita e shpalljes Pavarësisë dhe dita e Çlirimit të vendit nga okupacioni fashist, të pasqyruara në këtë fletë ditari, nga historiani dhe shkrimtari Haki Stërmilli. ëshë një dokument i vërtetë shkencor për historinë.

Rruga e jetës së Haki Stërmillit ishte rruga e jetës së një luftëtari të shquar, i cili tërë qenien e tij fizike e shpirtërore, tërë aftësitë e talentin e tij i vuri në shërbim të luftës për çlirimin e vendit, për ruajtjen e forcimin e identitetit kombëtar, si edhe për demokratizimin dhe prosperitetin e tij. Pjesë e kësaj lufte, madje edhe më e rëndësishmja, që e veçon Haki Stërmillin, është vepra e tij letrare.

Një ndër veçoritë më të spikatura në veprën letrare të Haki Stërmillit është lëvrimi i temës patriotike. Duke qenë nën përshtypjen e ngjarjeve tragjike të zhvilluara në vendlindjen e tij, dhe duke i pëjetuar ato edhe personalisht, si dhe duke

• Haki Stërmilli shkruan në ditarin e tij: “Mbas Konferencës së Pezës u rrjeshtova në kampin e Frontit Nacional Çlirimtar me besimin se kohët kishin ndyshuar dhe kjo luftë do të çlironte vendin nga fashizmi dhe do të realizohej edhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë”. Besimi i tij se do të realizohej kjo zgjidhje shprehet edhe në fletën e ditarit të datës 29 nëntor 1944, ku thotë: “Divizionet tona çliruan Prishtinën dhe po marshojnë drejt Kosovës”. Por edhe lufta Nacionalçlirimtare nuk i realizoi pritmeritë e luftëtarit patriot, ashtu si edhe të gjithë popullit shqiptar: Dy të tretat e trojeve shqiptare, ku bënte pjesë edhe Dibra e Madhe mbetën pësëri jashtë kufijve të shtetit shqiptar



i gërshetuar këto me ngjarje e probleme të jetës zakonore, Haki Stërmilli, jo vetëm që na ka dhënë vepra dinjitoze me vlera të veçanta ideo-artistike, por na ka lënë edhe një arkiv vlerash me të vërteta historike për njohjen e jetës dhe të zhvillimeve të kësaj periudhe.

## SFONDI I NGJARJEVE HISTORIKE NË ROMANIN “KALORSI I SKËNDERBEUT”

Në këtë trajtim të shkurtër duam të veçojmë disa nga vlerat e romanit historik “Kalorsit i Skënderbeut”, jo vetëm se është shkruar më pak për të, por na intregon edhe fakti: Përse Haki Stërmilli, e ndërpreu në vitin 1941, shkrimin e këtij romani dhe filloi përsëri ta shkruante në vitin 1952.

Romani “Kalorësi i Skënderbeut” është ndër-tuar mbi sfondin e ngjarjeve të vërteta historike të viteve 1451 - 1456, kur populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut luftonte trimërisht për mbrojtjen e tokave të shtetit shqiptar dhe për çlirimin e viseve të tjera të trojeve arbërore, të pushtuara nga osmanët, siç ishte edhe Kalaja e Sfidigradit. Duke hyrë në rrjedhën e ngjarjeve të kohës nëpërmjet të dhënave historike dhe traditës popullore, Haki Stërmilli ka arritur të na pasqyrojë atmosferën heroike të atyre viteve, duke na treguar se ndërgegjësimi patriotik i popullit ishte elementi thelbësor i sjelljes së kësaj atmosfere. Malësorët e thjeshtë trima e fisnikë ishin ata që përbënin ushtrinë e Skënderbeut e cila përballon me sukses hordhitë osmane. Këta malësorë trima janë edhe mbartësit e traditës dhe të zakoneve të tyre fisnike, pjesë e jetës së tyre të përditshme, që i

(Vijon në faqen 7)

## PROFILI

*Historia e burrit trim e të mençur që si hakmarrje u arrestua nga austro-hungarezët*

## SELMAN AHMETI LUFTOI TRIMËRISHT KUNDRA PUSHTUESVE SERBË E NAZIFASHISTË



**Nga Muharrem GJOKA**

**Mjeshtër i Madh & Nënkrjetar i OBVLP**

Mes 700 "tigrave" të Reç e Dardhës (siç njihen nga populli trimat reçjanë e dardhjanë) që qëndruan heroikisht dhe mposhtën bandën e Xhafer Balit në të ashququajturën "Beteja e Kodër Kacës" e 8 shtatorit 1941, ishte edhe burri trim e i mençur Selman Ahmeti i Reçit. Edhe Selmani ishte njëri nga "Tigrat e Maleve" të Reç e Dardhës që u mblodhën në Kodër të Kacës, i përcaktuar si vendi më strategjik për të mposhtur këtë bandë kriminale. Shumë domethënës ishte momenti kur takohen reçjanët me dardhjanët, shtrëngimi i duarve, besa e lidhur, vendimi i marrë, që i bënte ata të ecnin me kokën lart pa iu dridhur qerpiku.

Burrat e këtyre anëve kur shkonin në kuvende për beteja lufte me armikun, visheshin me rrobat më të mira. Nën, gratë e motrat e tyre i kishin përgatitur me kostumet më të bukura kombëtare të krahinës. Kështu si dritë shkëlqimtare spikaste edhe trimi Selman Ahmeti, i veshur bukur, që nga opingat me gjalma të bardha, çorapet të qëndisuar, tirq me gajtanë, këmbishën e bardhë me mëngë të lëshuara, brez leshe të thurur me larmi ngjyrash, xhamadanin me gajtanë e qelshen e bardhë, e deri tek sumbullat e xhamadanit, si dhe qestekun e sahatit që xixëllonte nga rrezet e

diellit e që krijonin shije artistike mahnitëse dhe të dukej sikur ishte me të vërtetë njëri nga krushqit e një dasme madhështore.

Në Kodër të Kacës u grumbulluan burrat e tre Maleve të Dibrës: Reçit, Dardhës e Çidhnës. Thonë se të gjithë u çuditën kur Xhafer Bali thirri emrin e Selman Ahmetit, të përjetësuar edhe në vargjet e këngës popullore: "Hajde, hajde Selman Ahmeti, me tirq të bardhë, me gajtana vrasheri...".

Ndërsa Selmani i përgjigjet: "Or Bal, shtatë krajla kanë përcjell këto troje e kështu do të përcjellim edhe ty me faqe të zeze".

Dhe ashtu si shqiponjë mali luftoi trimërisht Selman Ahmeti, krahas burrave të dheut derisa e përzunë Xhafer Balin me bisht ndër shalë...

Nuk ishte rastësi kjo qëndresë, pasi Selman Ahmeti, si edhe qindra e mijëra malësorë dibranë ishte kalitur ndër beteja të ashpra kundër pushtuesve serbë. Ai ka marrë pjesë trimërisht në luftën e Kolesianit dhe vite më vonë kishte treguar vendosmëri e trimëri të pashoqe në betejën e ashpra të Çidhnës.

Me vendosmëri iu është përgjigjur Selman Ahmeti i Reçit edhe pushtuesve austro-hungarezë. Me vrasjen e lejtnantit austriak në Reç, u bë reprezalje, ku shumë burra u vranë dhe disa të tjerë i arrestuan dhe i dërguan në burgun e Zhurit të Prizrenit. Mes këtyre burrave, i arrestuar ishte edhe Selman Ahmeti, të cilin e shpëtoi Elez Isufi.

I brujtur me ndjentat e zjarra të atdhetarizmit, Selmani ka qenë për gjashtë muaj me të birin, Manin, në Tiranë në mbështetje të Fan Nolit. Po ashtu ai ishte përkrah gjeneralit me shajak Elez Isufi, në luftën e Tiranës. Në këtë luftë ai është plagosur.

Ky burrë trim dhe i mençur, si dhe shumë të tjerë nga Reçi, Dardha e gjithë Dibra e priti me urrejtje të madhe pushtimin e vendit nga Italia fashiste me 1939. Bashkë me dhjetra patriotë Selman Ahmeti ka shkuar deri në Qafë Shtamë për t'u armatosur. Ata shkuan të mobilizuar për të luftuar pushtuesin italian, por fatkeqsisht atje konstatuan se armëve u kishin hequr shulat.

Selman Ahmeti ka lindur në fshatin Kraj Reç të Dibrës. Ai i përkiste një familje të mesme fshatare, patriarkale që përbëhej nga 12 veta: dy prindërit, i jati Ahmeti dhe e jëma Fazilja, katër djem e gjashtë vajza. Ndër katër djemtë, Selmani e Ademi njihen për qëndresën ndaj pushtuesve të huaj, ndërsa Cani dhe Daliu (dy të fundit) vdiqën nga helmimi i ujit në Durrës më 1920.

Kjo familje ishte shembull në gjithë krahinën

për solidaritetin mes vëllezërve, për dashurinë ndaj përditësve e motrave, për respektin e ndihmën ndaj miqve, secili më i mirë se tjetri. Por gjithsesi Selmanit i mbeti barra e drejtimit të familjes, si i pjekur para kohe. Ai që në vogëli dallohej për shkathtësi, zgjuarsi, dashuri e bujari.

Selman Ahmeti ka qenë pjesë e parisë së Reçit, ku gjithnjë e në çdo rrethanë kërkonte drejtësi, duke qenë krah të vegjëlve.

Në harkun kohor të viteve 1942-1944 Selman Ahmeti ka qenë sejmën në Glashnik, Maqedoni. Në maj 1944, kryekrinimeli Xhem Sinica, me forca të shumta sulmuan për të grabitur zonën që kishte në mbrojtje Selmani. Ai ra trimërisht në përleshje me këto forca, për të mbetur hero i heshtur. Gjithsesi la pas një familje të madhe, me katër djemtë: Man, Mustafa, Sadik e Ali Selmani (që ftakeqësisht asnjëri nuk jeton) si dhe vajzën e vetme Havë Selmani. Karakteristikë e kësaj familje qe harmonia e solidariteti, sidhe mirësia e bujaria, të trashëguara nga krijuesi i saj Selman Ahmeti. Pikërisht për akte trimërie e mençurie ai kujtohet në Reç e në gjithë Dibrën dhe nderohet si njeriu i dashur e human dhe si simbol i urtësisë e mençurisë dibrane.



## Mesazhe atdhetarie nga romani "Kalorësi i Skënderbeut"

(Vijon nga faqja 6)

trasmetojnë nga brezi në brez, dhe i ruajnë me fanatizëm si pasurinë e tyre më të shtrejtë. Protagonistët kryesorë të romanit nuk janë marrë nga figura historike por nga bijtë e popullit. Të tillë janë: Mark Spani (Kalori i Bukur) - protagonist kryesor i romanit, pjesëtar i Gardës Pretoriane të Skënderbeut, i cili mishëron veti e vrytete të luftëtarëve të kësaj epoke. Ai është: trim e besnik, kalorës fisnik, dashnor zemërzjarr, luftëtar i devotshëm i kauzës së shenjtë të atdheut.

Mira Mireshi, bija e luftëtarit të paepur të lirisë Zef Mireshi, vajza fytyrhënë me zemër të bardhë, besnike e dashurisë së pastër e të sinqertë me Kalorsin e bukur, por edhe luftëtare e patrembur dhe e vendosur në mbrojtje të lirisë e të jetës së kryerimit, mbretit të shqiptarve, Skënderbeut.

Këto figura e të tjera, si ajo e Hil Veshkuqit, e Qerimit dhe e motrës së tij, të ndërthurura me ngjarje e situata ku pasqyrohet atmosfera patriotike që rrethon popullin e ngritur në luftë, tregojnë edhe fatin e të rinjve dibranë, fati i të cilëve ishte

pleksur me fatet e Dibrës dhe të të gjithë vendit.

Figurën e Skënderbeut në roman, për mendimin tim, shkrimtari Haki Srërmilli, na e ka dhënë sipas modelit të shkrimeve për profetin Muhamed. Ndonëse është një figurë episodike, ai ndiehet në të gjithë romanin. Shkrimtari nuk e ka trazuar kryezotin me intrigat e aventurat dashurore, që ndodhin në trajtesën e romanit. Populli e quan atë diell që ngroh çdo zemër shqiptare. Në roman nënvizohet, jo vetëm misioni historik i Skënderbeut në luftë për tu bërë ballë agresorëve, por edhe për të krijuar një shtet të përqendruar shqiptar.

Në romanin "Kalorësi i Skënderbeut", pasqyrohen edhe prirjet separatiste të kohës të cilat kanë gjetur shprehje në trajtimin e dy figurave historike të kohës - Moisi Golemi dhe e shoqja princshë Zafina. Duke pohuar të vërtetën historike të tradhtisë e të pendimit të princit të Dibrës, Moisi Golemit, dhe rolin intrigues të princshës Zafina në këtë tradhti, autori jep mesazhin: Të kihet kujdes, se shkak i joshjes drejt separatizmit e tradhtisë ndaj interesave të atdheut janë po ato elemente e faktorë, që i kanë sjellë zhvillimet historike, që nga

agimet e shoqërisë njëzore.

Dua të ndaj me lexuesin, mendimin tim: Përse shkrimtari Haki Stërmilli, romanin "Kalorsin i Skënderbeut", që kishte nisë ta shkruante në vitet 1937-38, e ndërpreu në vitin 1941, dhe filloi ta shkruante pas Luftës së Dytë Botërore dhe e përfundoi në vitin 1952.

Haki Stërmilli ishte burrë me vizion të largët politik dhe njohës i shkëlqyer i gjeopolitikës, vçanërisht asaj në Ballkan. Vendimet e padrejta të Fuqive të Mëdha për copëtimin e tokave shqiptare, ku përfshihet edhe ndarja e Dibrës në dy pjesë dhe lënia e Dibrës së Madhe me trojet e tjera shqiptare jashta kufirit të shtetit shqiptar, vendosur më 1913, tronditën pa masë edhe zemrën e shkrimtarit patriot, ashtu si të gjithë popullit shqiptar. Pritmëria se me përfundimin e Luftës Parë Botërore do të rregullohej kjo padrejtësi, jo vetëm që nuk solli zgjidhje, por mbylli dhe shpresat. Kjo bëri që detyrat e shtetit shqiptar por edhe të shoqërisë shqiptare të ishin po ato të viteve 1451-1456, me ndryshimin e vetëm - atë të pushtuesit, nga turk në sllav. Ndaj në vitet 1937-38,

(Vijon në faqen 10)

## NDERIMI

Këshilli Bashkiak vlerëson gazetarin e shkrimtarin e mirënjohur dhe mësuesin veteran shembullor

# HALIL RAMA DHE SKËNDER MURRJA

## “QYTETAR NDERI” TË BULQIZËS

- Ky vlerësim nga Këshilli i Bashkisë Bulqizë, në përbërje të së cilës janë 8 Njësi Administrative: Qyteti i Bulqizës, Fushë Bulqiza, Zërqani, Shupenza, Gjorica, Ostreni, Trebishti dhe Martaneshi, vjen në konsiderim të propozimit nga OBVLP dhe Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe me propozimin e kryebashkikes Festime Mjeshtri, në emër të qytetarëve të Bulqizës

Një ceremoni madhështore me praninë e më shumë se 300 pjesëmarrësve, qytetarë, personalitete të letrave, artist e Kulturës, mësues, maturantë të gjimnazit të Bulqizës, punonjës të administratës vendore etj, që kishin mbushur kinemanë e qytetit minator, gazetari e shkrimtari i mirënjohur Halil Rama dhe mësuesi veteran shembullor Skënder Murrja janë vlerësuar të enjten e 14 Nëntorit 2024 me titullin “Qytetar Nderi” i bashkisë Bulqizë.

Ky vlerësim nga Këshilli i Bashkisë Bulqizë, në përbërje të së cilës janë 8 Njësi Administrative: Qyteti i Bulqizës, Fushë Bulqiza, Zërqani, Shupenza, Gjorica, Ostreni, Trebishti dhe Martaneshi, vjen në konsiderim të propozimit nga OBVLP dhe Shoqata “Bashkësia Dibrane” dhe me propozimin e kryebashkikes Festime Mjeshtri, në emër të qytetarëve të Bulqizës. Vlerat e dy personaliteteve që iu dha titulli më i lartë që jep Këshilli Bashkiak, u evidentuan më së miri nëpërmjet dy dokumentarëve që u ndoqën me interes të veçantë nga pjesëmarrësit.

Pas vlerësimit që ju bëri kryebashkiakja Mjeshtri dy personaliteteve, Zotërinjtë Rama e Murrja i shprehën asaj mirënjohje të veçantë për përkushtimin dhe vizionin bashkëkohor me të cilin drejton Bashkinë e Bulqizës, duke realizuar një transformim rrënjësor në infrastrukturë dhe duke ndikuar në realizimin e veprimtarive të larmishme në kuadrin e 80 vjetorit të çlirimit të atdheut. Ceremonia u moderua me mjeshtri të rrallë artistike nga ikona e skenës dhe ekranit, Mjeshtri i Madh Llesh Nikolla, ndërkohë më të larmishëm e bënë këtë event me performancën e tyre artistike, këngëtarit i talentuar Dritan Jashari – Nderi i Kulturës Dibrane, si dhe valltarët e Qendrës Kulturorë të Fëmijëve Bulqizë.



HALIL HIDËR RAMA, GAZETAR DHE SHKRIMTAR PROFESIONIST

Halil Rama u vlerësua me titullin “Qytetar Nderi” i bashkisë Bulqizë për kontributin e tij “Si shkrimtar, skenarist e publicist, i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Bulqizës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”.

Marrëdhëniet e tij me qytetin e Bulqizës nisnin që vitin 1987 si metodist i kulturës në Shtëpinë e ushtarakëve, për të vijuar më pas si Sekretar i Komitetit Ekzekutiv Pulualist të Këshillit të Qytetit dhe si Shef i Administratës së Këshillit të Rrethit Bulqizë nga viti 1991 deri në vitin 1998.

Ka jetuar këtu për 11 vjet me familjen e tij dhe ka krijuar profilin e një kuadri e intelektualit me reputacion, të devotshëm, të nderuar e të respektuar nga qytetarët e Bulqizës.

Është themelues dhe drejtues i gazetës “Bulqiza” që më 5 maj 1992 e në vazhdim deri më 1998 dhe ka rinisur botimin e saj sërish nga viti 2010 e në vazhdim, ku me kompetencë e profesionalizëm ka pasqyruar zhvillimet e vrullshme të Bulqizës, hitorinë, traditat dhe personalitetet e saj. Gjithashtu ai drejton gazetën “veteran” si kryeredaktor i saj prej 22 vitesh. Në këtë gazetë si dhe në gazetën qendrore “PANORAMA”, “DITA”, “GAZETA SHQIPTARE”, “TELEGRAF” etj ka botuar çdo 18 shkurt historinë e gjerë në minierës së Bulqizës, si dhe në vijimësi ka pasqyruar veprimtarinë e OBVLP. Në 27 librat e tij (letërsi dokumentare+poezi dhe tregime) si dhe si skenarist e regjisor i 9 dokumentarëve televizivë Halil Rama

prezantohet si mjeshtri i profilit, duke krijuar personazhe si shëmbëlltyra që të mbeten në kujtesë.

Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtri di të përveçojë protagonistët të veshur me detaje, që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshhtërisht.

### SKËNDER RAMIZ MURRJA, MËSUES VETERAN SHEMBULLOR

“Është i njohur për kontributin e dhënë në zhvillimin e sektorit të arsimit në Bashkinë e Bulqizës e atë të Dibrës, i cili për 42



vjet, si mësues, drejtor shkollë (20 vjet në shkollat e Dibrës dhe 22 vjet në Bulqizë), inspektor dhe Drejtor i Zyrës Arsimore Bulqizë ka krijuar një karrierë të shkëlqyer profesionale dhe intelektuale. Është dalluar për profesionalizëm, përkushtim dhe vizion bashkëkohor”. Ky është motivacioni

që shoqëron Titullin “Qytetar deri” i Bashkisë Bulqizë.

Nga strukturat përkatëse drejtuese në qarkun e Dibrës e Bashkinë e Bulqizës S.Murrja është vlerësuar për rritjen e nivelit në formë e përmbajtje, të punës së komisioneve kualifikuese në bazë shkollë e rrethi, për t’ju dhënë zgjidhje problemeve të përmbajtjes së punës me nxënësin.

Si ekspert shembullor ai ka ndikuar në ngritjen e nivelit të veprimtarive me sukses kërkesave në arsimin e mesëm dhe të lartë. Ndërkohë ka realizuar studimin e mirëfillt të punës me kuadrin për t’ju përgjigjur në kohë e me cilësi kërkesave të punës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Gjatë karrierës së tij 42 vjeçare si mësues dhe drejtues në disa shkolla e institucione arsimore, Skënder Murrja ka marrë vlerësime maksimale, deri edhe nga Ministria e Arsimit. Kështu, më 16.04.1984 ai është vlerësuar nga Ministria e Arsimit Tefta Cami me Distinktivin “Mësues i Dalluar”, me motivacionin: “Për përgatitje të mirë ideologjike,shkencore e pedagogjike, për punë të ndërgjegjshme dhe për arritje të larta në procesin mësimor-edukativ.

Më 01.04.2002. ka marrë Certifikatën: “Shkolla pilot në Edukimin e të Drejtave të njeriut, një eksperiencë e re pune” nga Drejtore ekzekutive e QSHDNJ Kozara Kati dhe Drejtore e IS: Erlehta Mato. Skënder Murrja është vlerësuar edhe me Certifikatën “Për kontributin e dhënë në lëvizjen sindikale në arsim” (më 26.04.2016.) nga Kryetari i FSASH Xhaferr Dobrushit. Për 11 vite (2008-2019) ka qenë Kryetar i FSASH (Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës) për bashkinë Bulqizë.



## VLERESIMI

Me propozimin e Kryesisë së Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve

# Kryebashkiaku Veliaj, “Çertifikatë Mirënjohje” për veteranin shembullor Shuaip Methasani

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj ka vlerësuar me Çertifikatë Mirënjohje veteranin shembullor Shuaip Methasani, në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij.

“Mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, duke qenë një nga përfaqësuesit e denjë të komunitetit dibran në Tiranë”, është motivacioni i kësaj Çertifikate Mirënjohje, të cilën kryebashkiaku Veliaj ia akordoi veteranit Methasani në konsiderim të propozimit të bërë nga Kryesia e OBVL, anëtar i së cilës ai është prej vitesh.

Në ceremoninë festive të organizuar me këtë rast, Çertifikata e Mirënjohjes iu dorëzua solemnisht veteranit Methasani nga këshilltarja e kyetarit të Bashkisë Tiranë, Znj. Gjinovefa Kadriu.

Në këtë ceremoni merrnin pjesë gjithashtu Dr. Sali Kurti - Mjeshtër i Madh & Qytetar Nderi i rrethit Mat dhe “Njeriu i vitit” i Federatës së Paqes Universale Shqipëri; Nënkyetari i OBVL Muharrem Gjoka - Mjeshtër i Madh dhe “Nderi i Qarkut Dibrë” si dhe pjetarë të familjes së nderuar Methasani.

Kryesia e OBVL e bëri këtë propozim/vlerësim për faktin se veteranin Shuaip Methasani, pothuajse në të gjitha veprimtaritë promovuese të kësaj organizate të dhjetë viteve të fundit, si edhe në Kuvendin Zgjedhor të Korrikut të këtij viti, ka spikatur me prezencën dhe performancën e tij. Ai njihet si intelektual që mishëron vlerat më të mira njerëzore si dhe për zgjuarsinë, mençurinë, fisnikërinë, dashurinë njerëzore, sinqeritetin, drejtësinë, solidaritetin, moralin e lartë dhe shpirtin human si fundamente kyçe të shoqërisë sonë. Dhe të gjitha këto virtyte ai i përçon më së miri edhe në dy librat e tij: “Sohodolli i Dibrës” dhe “Kujtime në vite”. Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja e tij, Sohodolli, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë, traditat më të mira të këtij fshati e të krejt Dibrës. Këto janë padyshim dhurata më e çmuar për njerëzit e familjes, farëfis, të afërmit, shokët e miqtë e tij të



Në ceremoninë festive të organizuar me këtë rast, Çertifikata e Mirënjohjes iu dorëzua solemnisht veteranit Methasani nga këshilltarja e kyetarit të Bashkisë Tiranë, Znj. Gjinovefa Kadriu. Në këtë ceremoni merrnin pjesë gjithashtu Dr. Sali Kurti - Mjeshtër i Madh & Qytetar Nderi i rrethit Mat dhe “Njeriu i vitit” i Federatës së Paqes Universale Shqipëri; Nënkyetari i OBVL Muharrem Gjoka - Mjeshtër i Madh dhe “Nderi i Qarkut Dibrë”, si dhe pjetarë të familjes së nderuar Methasani

**Vlerësimi në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij, me motivacionin: “Mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, duke qenë një nga përfaqësuesit e denjë të komunitetit dibran në Tiranë”**



shumtë në gjithë Shqipërinë dhe hapësirën mbarëshqiptare në botë. Njeriu i mirë dhe i veprave të mira Shuaip Methasani gjatë gjithë jetës së tij ka rrezatuar dhe përçuar mirësi, por dhe vlera në dobi të shoqërisë.

## TAVOLINA E DIBRANËVE

Tek libri “Kujtime në vite”, një mesitull interesant (faqe 62) është “Tavolina e dibranëve”. Intelektuali që ka shërbyer me devotshmëri e përkushtim qytetar për afro dy dekada, pothuajse në të gjitha krahinat e fshatrat e Dibrës, edhe këtu në metropolin shqiptar, ku është vendosur familjarisht prej shumë vitesh, punon pa rreshtur për të lartësuar emrin dhe dinjitetin e dibranëve. Nëse në Tiranë njihen nga shumëkush “Rruga e Dibrës”, “Lagja e dibranëve”, (e krijuar e shumëfishuar përgjatë një shekulli që nga eksodi i tyre i 1913, e sidomos pas viteve ‘90), apo dhe Xhamia “Dine Hoxha” në rrugën e Kavajës (e ndërtuar me kontributin financiar të filozofit popullor të mirënjohur si një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog I), “Tavolina e dibranëve” në një lokal kafeneje në qendër të Kombi-

natit, është një tjetër vlerë e shtuar e këtij komuniteti, e ideuar dhe promovuar më së miri nga intelektualit i mirënjohur Shuaip Methasani. Këtu ai është njherazi edhe përçuesi më i mirë i alegorisë dibrane, të përvetësuar në odat e kuvendet e Dibrës, por edhe nga kryevepra e Hazis Ndreut “Alegoria dibrane” si dhe nga “Kanuni” i shkrimtarit të shquar dibran Xhafer Martini. Libri ka qenë miku dhe bashkëudhëtari më i mirë i Shuaipit në nëntë dekadat e jetës së tij, ndaj mos u çudisni nëse nga një vizitë rastësore në shtëpinë “Methasani” në një lagje të Kombinatit në Tiranë, do të gjeni një bibliotekë aq të pasur, konkurente në tituj e rubrika me ato të institucioneve. Ndërsa në bibliotekat tona, dy librat e tij duhet të zënë vend nderi, pasi ua kushton prindërve (babait Sulejman dhe nënës Fie), motrave Hike e Servete që e kanë mbajtur në krah kur ishte i vogël, bashkëshortes Farie - një zonjë e nderuar e fisnike, fëmijëve të mrekullueshëm: Defrim (moderator i shkëlqyer i dhjetra veprimtarive promovuese e argëtuese dhe ndër më të mirët e gazetarisë sportive në rang kombëtar), Artanit, Natashës, Nderimes e Lilianës që e kanë nderu-

ar si me shkollimin dhe me punët ku kanë punuar e punojnë, dy nuseve të djemve, Lume e Naze, nipave e mbesave që e lumturojnë pafund, miqve dhe shokëve të tij të mrekullueshëm...Një përkushtim brilant për ata që përbëjnë embrionin e familjes nga buron atdhedashuria e tij e flaktë. Dhe në çdo faqe të tyre gjejmë aspekte nga historia e lavdishme e popullit tonë, por dhe ngjarje e detaje jetësore befasuese.

Vetëm një studjues tejet i vëmendshëm e skurpuloz si Shuaip Mehtasani mundet të evidentojë kaq shumë emra të spikatur dibranësh në fusha të ndryshme, siç evidenton “odën e burrave”, “traditën e fisit”, objektet dalluese të vendlindjes së tij, “sohodollasit e Tiranës” apo “Familjet nga Sohodolli me banim në Tiranë”. Parë në tërësinë e individualitetit të tij krijues, Shuaip Methasani është një enciklopedi e gjallë për Dibrën e dibranët.

Ndaj, është plotësisht e merituar nga Ai, “Çertifikata e Mirënjohjes” që i akordoi Kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, si veteran shembullor, në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut nga okupatori nazifashist.



## 80-VJETORI

## OVLANÇ E KOSOVËS, VEPRIMTARI PËRKUJTIMORE NË GJAKOVË, PRIZREN E PRISHTINË



• Me rastin e 80 vjetorit të fitores kundër nazifashizmit, Kryesia e Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës ndau mirënjohje individëve që kontribuan në afirmimin e vlerave të LANÇ: Mirënjohje u ndanë për: veteranin e luftës Xhafer Haxhijakupi, Mjeshterin e Madh, kryeredaktorin e të gazetës "Veterani" në Tiranë, Halil Rama; Post mortum ish antarëve të Kryesisë së Organizatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës Musa Dobruna dhe Shefqet Vokshi dhe për mbështje ndaj kësaj organizate, Sejfulla Deçani nga firma "Alba qeramika" Pejë

## Fitorja mbi nazifashizmin ishte fitore mbi të keqen dhe krimin

nazifashizmit. U përkujtuam, nderuan dhe u respektuan figura të rëndësishme të LANÇ. U mbajtën mbledhjet solemne dhe në varrezat e heronjve dhe dëshmorëve, u vendosën kurora dhe buqeta me lule të frerskëta.

Në 80 vjetorin e çlirimit të qytetit të Gjakovës anëtarët e Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, dega Gjakovë bashkë me familjarët e dëshmorëve bënë homazhe në varrin e Heroit të Popullit Fadil Hoxha, bashkëshortës së tij Vahide Hoxha, ish kryetare e kësaj organizate dhe në varrezat e dëshmorëve të UÇK-së. Homazhe bënë edhe në Kompleksin memorial "Fadil Hoxha" në kodrën e Çabratit. Ndërkaq, për nder të 80 vjetorit të çlirimit të qytetit, në pallatin e kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë, u mbajt mbledhja solemne ku para të pranishmeve, për LANÇ, folën nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Bashkim Hisari dhe kryetari i degës në Gjakovë Skender Hoxha. Për

nderë të ditës së çlirimit të Gjakovës u promovua edhe Monografia: "Shaban Haxhia, Komandant i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare i Malësisë së Gjakovës dhe i Brigadës së Shtatë të Kosovës" e autorit Skënder Demalijaj. Për këtë vepër dhe meritat e komandantit Shaban Haxhia foli Akademik Akif Bajrami.

Buqeta me lule dhe kurora u vendosën edhe në varrezat e Heronjve të Popullit Emin Duraku dhe Mustafa Bakija në varrezat e qytetit të Prizrenit.

Ceremonija qendrore e shënimit të fitores kundër nazifashizmit u organizua në Prishtinë. Në mbledhjen solemne folën Dr. Alban Dobruna, nga Instituti i Historisë të Kosovës, Lekë Hoxha, kryetar, Zija Mullhaxha dhe Bashkim Hisari, nënkryetar të organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës si dhe Nazmije Peja-Duraku, motra e heroit të popullit Emin Duraku dhe prof. Xhevat Koshi.

Ata pos tjerash thanë se në momentin historik populli shqiptar i Kosovës u rreshtuan në bllokun antifashiste. Luftuan për liri, barazi dhe vetëvendosje.

"80 vjet më parë, përfundimi i luftës ishte shumë më tepër se një dëshmi për fillimin e fundit të një prej "episodeje" më të errëta në historinë e njerëzimit. Fitorja në Luftën e Dytë Botërore ishte fitore mbi të keqen dhe krimin. Ishte një histori e përgjakshme njerëzore. Kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e Lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në këtë fitore të madhe. Në bazë të kësaj lufte të përgjakshme dhe sakricave që bënë partizanët shqiptarë nga Kosova bashkë me ata të Shqipëria, u sigurua jo vetëm liria por edhe e drejta për vetëvendosje dhe Shqipëtarët të jetojnë në trojet e tyre etnike", - theksuan ata.

Me rastin e 80 vjetorit të fitores kundër nazifashizmit, Kryesia e Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës ndau mirënjohje individëve që kontribuan në afirmimin e vlerave të LANÇ: Mirënjohje u ndanë për: veteranin e luftës Xhafer Haxhijakupi, Mjeshterin e Madh, kryeredaktorin e të gazetës "Veterani" në Tiranë, Halil Rama; Post mortum ish antarëve të Kryesisë së Organizatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës Musa Dobruna dhe Shefqet Vokshi dhe për mbështje ndaj kësaj organizate, Sejfulla Deçani nga firma "Alba qeramika" Pejë.

### Bashkim HISARI

**M**e aktivitete të veçanta në Gjakovë, Prizren dhe Prishtinë u shënuar 80-vjetori i fitores kundër



## Mesazhe atdhetarie nga romani "Kalorësi i Skënderbeut"

(Vijon nga faqja 7)

Haki Stërmilli filloi të shkruante romanin historik "Kalorësi i Skënderbeut", shkrimin e të cilit e ndërpreu me fillimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe konkretisht pas prillit të vitit 1941, kur u realizua bashkimi i trojeve shqiptare në një shtet të vetëm me qendër në Tiranë.

### NDËRGJEGJËSIMI PATRIOTIK I MASAVE POPULLORE PËR DOMOSDOSHMERINË E BASHKIMIT KOMBËTAR

Haki Stërmilli shkruan në ditarin e tij: "Mbas Konferencës së Pezës u rreshtova në kampin e Frontit Nacional Çlirimtar me besimin se kohët kishin ndryshuar dhe kjo luftë do të çlironte vendin nga fashizmi dhe do

të realizohej edhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë". Besimi i tij se do të realizohej kjo zgjidhje shprehet edhe në fletën e ditarit të datës 29 nëntor 1944, ku thotë: "Divizionet tona çliruan Prishtinën dhe po marshojnë drejt Kosovës". Por edhe lufta Nacionalçlirimtare nuk i realizoi pritmeritë e luftëtarit patriot, ashtu si edhe të gjithë popullit shqiptar: Dy të tretat e trojeve shqiptare, ku bënte pjesë edhe Dibra e Madhe mbetën pjesërisht jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Kjo ishte dhimbja më e madhe e këtij luftëtari të paepur. Por me gjithë këtë dhimbje, me gjithë rëndimin e viteve e lodhjes që i solli lufta trevjeçare në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shkrimtari patriot nuk dorëzohet. Ai i rikthehet shkrimit të romanit, e përfundon atë, duke na bërë me dije se detyra nuk kishte mbaruar dhe me gjuhën e Dibrës, do të sugje-

ronte edhe rrugët për realizimin e saj, në radhë të parë ndërgjegjësimi patriotik i masave popullore, që të viheshin në lëvizje për të realizuar bashkimin e trojeve shqiptare. Nuk ndaj të njëjtin mendim edhe për kritikën që i bëhet veprës së Haki Stërmillit, sidomos asaj të viteve të mbretërisë, kur thuhet se kufizimet botëkuptimore nuk e kanë lejuar shkrimtarin që në krijimtarinë e tij të shtrojë nevojën e përmbysjes së rendit shoqëror ekzistues, por kufizohet vetëm në mohimin e disa normave të moralit dhe mentalitetit sundues të kohës. Unë mendoj se nuk janë kufizimet botëkuptimore, por vizioni dhe symprehtësia e shkrimtarit, që i lexonte në thellësi zhvillimet gjeopolitike të kohës, për të mos përdorë "grushtat migjenian" për rrëzimin e monarkisë. Shkrimtari patriot e kishte të qartë se në vitet "30, kur të gjitha

shtetet e Ballkanit ishin monarki dhe kur synimet e tyre grabitqare ishin në rend të ditës, rrëzimi i monarkisë do të ishte një rrezik real për copëtimin e plotë të tokave shqiptare. Ai e kishte të qartë gjithashtu, se monarkia do të ishte një siguri më e madhe për ruajtjen e pavarësisë së shtetit të ri shqiptar. Haki Stërmilli, kur viheshin në rrezik interesat e atdheut e të kombit, për të cilat kishte luftuar gjithë jetën, me gjithë kundërshtitë që kishte me Mbretin Zog, dhe persekutimin që ai i kishte bërë, nuk do t'ia lejonte vetes kurrë që veprimtaria e tij të cënonte interesat madhore të kombit.

\*\*Studjues - "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" i Institutit të Studimeve historike të Akademisë së Shkencave - Tiranë, që nga viti 1978

## 80-VJETORI

Në Iballë u bë mbledhja e parë e Këshillit Nacional Çlirimtar të Nënprefekturës së Pukës

# BATALIONI PARTIZAN PUKA NË 80-VJETORIN E KRIJIMIT

*Batalioni Partizan "Puka" në mes të Brigatës XXII-S, 23 nëntor 1944*



**Xhemal Meçi**

**"Mjesht i Madh" & Studiues**

**B**rigadat partizane të VI dhe XXII-S, si morën pjesë në luftën për çlirimin e Shënpalit dhe të mbarë Mirditës, kaluan në fshatrat e Pukës, për çlirimin e tyre dhe vendosjen e Pushtetit të Frontit Nacional Çlirimtar. Rol luajtën edhe Këshillat NÇL, të zgjedhur nga populli në prani të partizanëve të këtyre Brigatave. Kështu në Qerretin e Epër, me 3 nëntor u zgjodh Këshilli ANÇL: Kryetar Kadri Kasemi, sekretar Idriz Meti ndërsa një prej antarëve të Këshillit të parë Antifashist NÇL u zgjodh, Hoxha i Qerretit, Qazim Nushi, emigrant politik Kosovar nga Gjakova. Në Qerret janë srehuar edhe aktivist të Qarkut Shkodër, si Nuri Llazani, Sadik Bekteshi etj.

Në vazhdim Brigada VI-S vazhdoi udhëtimin për Iballë, nëpër Dedaj, ku sekretari i KANÇL u zgjodh Zenel Islami (ish nënës i Migjenit, për të cilin ka shkruar skicën "Zeneli", të cilin e kishte si nxënësin ideal të Tij.). Brigadën e VI-S që veproj në Qelzë, Bushat, Midhë, Berishë Vendi, Spaç e Iballë, e priten rreth 80 iballës të rreshtuem nën kujdesin e Mehmet Ramës, Mal Bajram Sokolit, Mal Jah Zenelit, baza të rëndësishme të LANÇ. Gjithashtu u rreshtua me ta edhe Stak Pjetër Pemati etj. Në krye të kësaj kolone mikpritëse vazhdoi Zenel Mustaf Aga, i biri i Zenel Mustafë Agës Iballë, mikpritës e strehues i patriotit Bajram Curri.

Në Iballë u bë mbledhja e parë e Këshillit Nacional Çlirimtar të Nënprefekturës së Pukës, i cili zgjodhi si Kryetar të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Pukës Elez Hoxhën, myftia i Pukës, përkrahës e strehues e Ali Bytyçi, i cili u emërua Komisar Politik i Frontit ANÇL për Rrethin e Pukës. Ali Bytyçi kishte shoqëruar bashkë me 20 qerretas Brigadën e VI-S deri në Iballë. Mandej kaluan Qerretas,


Iballës, Berishës, Bugjonas me Brigjet e Iballës me dhjetra partizanë në radhët e Brigatës XXII-S, që u ngarkua për çlirimin e qytetit të Pukës. Qendra e rrethit, u sulmua dhe u çlirua prej fashistëve vendas, milicisë fashiste dhe një grupi forcash gjermane të cilët sulmuan Qerretin me 4 nëntor 1944 si hakmarrje që përkrahen Brigadën VI-S dhe i dhanë mbi 20 të rinjë e burra partizanë. Qerri me pak burra u mbrojt prej milicis dhe forcave të mbetura gjermane që vendosen topat për ballë fshatit, të cilin e rrahën me predha artilerie; kurse milicët hynë brenda në fshat, ku filluan terrorin me grabitje, djegëje, vrasje, sado që u pritën me armë. Në këto luftime ranë deshmorë: Ymer Çoba, Bajram Toska, Rrustem Toska, Zojë Djaloshi (e ëma e Nezir Djaloshit, dhe i dogjën shtëpinë).

Mbas këtij terrori, milicia u tërhoq nga frika se mos i sulmonin partizanët nga prapa. Kurse grupi gjermanë u tërhoq për në Shkodër, si hodhën në erë urën e Gomsiqes, siç u hodhë së fundi Ura e Vadejës.

rës me Komandant Zef Miraka dhe Komisar Zef Gashi. Ky Batalion nuk u formua si rastësisht, por si rezultat i qëndrimit armiqësor ndaj pushtuesve nazifashist, duke u bashkuar rreth çetave partizane: si ajo e Pukë-Has, më 1941, e Ymer Bardhosh Laçit, ish kapiten rezerve i gjandarmërisë së Mbretit Zog. Po kështu u formua më 1941 edhe çeta Pukë - Mirditë me komandant oficerin Zogist Pashk Nikoll Curri. Që dy këto çeta pranuan për komisar ish-aktivist politik të Qarkut Shkodër. Çeta Pukë-Has pranoi Komisar Isa Agovikun, kurse ajo Pukë-Mirditë pranoi Komisar Nuri Llazanin, të cilët i orientuan këto çeta të kryenin aksione kundër pushtuesve fashist siç u arrit sulmi i çetës Pukë-Has në Qafë-Likmetë të Malziut, ku mbetën të vrarë ushtarë italianë, të cilët si u erdhën forca ushtarake, sulmuan fshatin Gdhesht, bazë e rëndësishme e çetës Pukë-Has. Fshati u dogj kurse disa fshatarë i morën robë. Edhe çeta Pukë - Mirditë kryente sulme duke prishë ura të vogla në rrugën automobilistike

Të gjitha këto zona i përshkonte militanti Ali Bytyçi, ku mbante gjallë dhe ushqente qëndrimin antifashist.

Në këto rrëthana u çlirua Puka-qytet dhe u formua Batalioni Partizan "Puka", në rradhët të të cilin hynë edhe të rinjë nga Iballa me Brigje, Berisha, Kryeziu, Gojani etj., si dhe nga Kabashi, të njohur me emrin "Tre Sadikat": Sadik Cina, Sadik Hysen Kopani, dhe Sadik Gjura, i cili u vendos së fundi në Korçën e çliruar. Kurse dy Sadikat e tjerë morën të ftohur të rëndë gjatë luftimeve në Vishegrad dhe si u kthyen, vdiqën nga tuberkulozi, si dhe Ndue Nikolli i Iballës. Në gazetën "Bota Shqiptare" (1 maj 2000) dhe librin "Veteranët tregojnë" (nr 2, fq.114) me autor Mark Dodanin, ish-partizan i Çetës Pukë-Mirditë, shkruam: "Populli antifashist dhe Batalioni "TRIADA" i Pukës, që shndriti faqet e histories pukjane të Luftës NÇL të popullit Shqiptar, ndihmoi në kuadrin e Br. XXII-S në luftën për Çlirimin e Shkodrës, nga anan V.L. Kurse me



Si përfundim, si u forcua me dhjetra partizanë pukas, Brigata XXII sulmoi dhe çliroi Pukën, qendra e fundit e Rrethit, ku që në mëngjes të 20 nëntorit u vendos pushteti i ri Nacionalçlirimtar dhe me idenë e të ndjerit Ali Bytyçi hapën zyrat e tyre. Këtyre u lindi dëshira që edhe Puka të dilte para krahinave të tjera me një forcë të organizuar në formacione të mëdha partizane, në një Batalion partizan. Si u konsultuan me familje partizanësh, baza të LANÇL dhe aktivistesh të rinisë ANFNÇL, u vendos të formohej Batalioni Partizan "PUKA", me 200 pjesmar-

Kukës - Pukë - Gomsiqe. Por kryesorja, arritën të vendosnin rendin e tyre që nga Hasi - Kryezi, Gojan - Gomsiqe - Dush etj. Në Dush e mbyllën zyrën e Komunës, e cila u detyrua të vendosej në fshatin Qërret i Epër. Në luftë ishte përfshirë edhe çeta nacionaliste e udhëhequr prej ish-kapitenit zogist Xhemal Laçi me ndikim Kabash - Micoj - Kryezi - Flet - Trun deri në Petkaj e Vaspas të Malziut bashkë me atdhetarin Ymer Ymeri i Truenit, zona në fakt të çliruara ku nuk mund të hynin forcat pushtuese nazifashiste, as milicia fashiste me qendër në Pukë qytet.

29 Nëntor 1944 si u formua Br. XXVII-S e Shkodrës, Batalioni Partizan "Puka" u radhit në Br.Partizane NÇL të Qarkut Shkodër me komandant birin Kosovar Sadik Bekteshi dhe mori pjesë në të gjitha luftimet kundër forcave naziste gjermane në Vishegradin Jugosllav. Autori M. Dodani e mbyll shkrimin e tij me porosinë që LNÇL e popullit pukjanë si dhe Batalioni Partizan "Puka" nuk duhen harruar se "e vërteta nuk do ta lejtë vendin gjithmonë bosh".

## EKSPOZITA

Në 80-vjetorin e ndarjes nga jeta që përkon me 120 vjetorin e udhëtimit të saj të patë në Shqipëri

# PËRMET- EKSPOZITË ME FOTO DHE SKICA TË EDITH DURHAM

- Kryetarja e bashkisë Përmet, znj. Alma Hoxha, midis të tjerash tha: “Nderojmë me këtë ekspozitë Mary Edith Durham, këtë grua të jashtëzakonshme që ka lënë gjurmë të thella në kulturën dhe historinë e Shqipërisë. Përmes udhëtimeve dhe shkrimeve të saj në librin “Higt Albania” (Shqipëria e lartë) të botuar në vitin 1909, ajo na ka sjellë një pamje të mrekullueshme të jetës dhe traditave shqiptare, duke përfshirë dhe qytetin tonë të dashur, Përmetin

## Muharem Kamani

“Miss Mery Edith Durham - Mbretëresha e Malevet Shqiptare” (1863-1944).

Ky është titulli i ekspozitës së hapur në Muzeun Historik të Përmetit, me rastin e 80 vjetorit të ndarjes nga jeta, që përkon dhe me 120 vjetorin e udhëtimit të saj të parë në Shqipëri. Kjo ekspozitë e çelur më 14 nëntor në QKMF “Odise Paskali”, në sallonin e madh, përmban foto të ndryshme dhe skica në kohëra të ndryshme në viset shqiptare në të pesë udhëtimet e saj biblike.

Ekspozita që i bën homazh veprës së Durham qëndroi e hapur për një javë për publikun. Ajo ngjalli shumë interes me informacionin që jepte. Në ditën e parë të çeljes së saj ishin të pranishëm mjaftë vizitorë, krijues e artistë, dashamirës të artit, punonjës të bashkisë, qytetarë dhe nxënës të gjimnazit “Sami Frashëri” etj.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtoresha e Muzeut, znj. Elsjona Kote, e cila u ndal te ndikimi i Edith Durhamit për njohjen e kulturës shqiptare kudo në botë. “Edith Durham e kishte origjinën nga një familje e madhe dhe e pasur nga veriu i Londrës. Ajo ishte më e madhja e fëmijëve midis tre vëllezërve e gjashtë motrave të cilët ishin të suksesshëm në jetë e në karrierën e tyre.

Vetë Edith-i përfundoi “Bedford College” në Londër (1878-1882) dhe më pas studioj për pikturë dhe vizatim në Akademinë Mbretërore të Arteve.

Në këtë kuadër në 1899 ajo bëri ilustrimet për vëllimin e kolanës Cambridge natural History dhe më vonë ka lënë skica dhe piktura të shumta nga Ballkani. Ajo do të mbetet përgjithmonë si një grua e rrallë dhe një kujtim i bukur për shqiptarët, një personalitet i nderuar dhe i dashur”, tha ndër të tjera znj. Kote.

Në çelje të ekspozitës përshëndeti edhe Kryetarja e bashkisë Përmet, znj. Alma Hoxha, e cila midis të tjerash tha: “Nderojmë me këtë ekspozitë Mary Edith Durham, këtë grua të jashtëzakonshme që ka lënë gjurmë të thella në kulturën dhe historinë e Shqipërisë.

Përmes udhëtimeve dhe shkrimeve të saj në librin “Higt Albania” (Shqipëria e lartë) të botuar në vitin 1909, ajo na ka sjellë një pamje të mrekullueshme të jetës dhe traditave shqiptare, duke përfshirë dhe qytetin tonë të dashur, Përmetin.

Siç shkruan Edith Durham: “Përmeti i vendosur në mes të maleve është një qytet që mbart me vehte pa-



surinë e një historie të lashtë dhe të pabesueshme. Njerëzit e tij të lidhur ngushtë me tokën, traditat janë një pasqyrë e vërtetë e forcës dhe e mikpritjes shqiptare “. Ky citim sjell në mëndje një nga tiparet më të bukura të qytetit tonë, lidhjen e ngushtë mes natyrës dhe njerëzve. Përmeti me bukuritë e tij natyrore dhe trashigiminë e pasur kulturore ka luajtur gjithmonë një rol të veçantë në jetën e shqiptarëve dhe në atë që Edith Durham e quajti “Shpirti i Shqipërisë”.

Historiani Kastriot Bezati vlerësoi Mary Edith Durham si atdhetare e madhe dhe dashamirëse e shqipërisë. Mjafton për këtë, vlerësimi që ajo u ka bërë traditave historike e kul-



turore, sidomos të parashkuara te vepra e saj madhore “Brenja e Ballkanit”. Ajo është shpallur “Sekretare Nderi” e Shoqatës së Miqësisë Angli-Shqipëri në vitin 1918. Me vlera të veçanta është letra që i dërgon Fan S. Nolit me rastin e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Dhjetor 1920. E madhja Edith Durham në hapësirën gjeografike mbarë shqiptare flet për vlerat kulturore e historike të qytetit e trevës së Përmetit.

Z. Andrea Llukani, punonjës i MHK u shpreh në fjalën e tij se, Durham, që ditën e parë që shkeli në tokën shqiptare u mrekullua, jo vetëm nga natyra, por dhe nga shpirti dhe vlerat morale të shqiptarëve. Madje dhe vet u tregua shqiptare me zëmër dhe me shpirt.

Kjo është arësyeja pse të gjithë shqiptarët e nderojnë, respektojnë dhe e kujtojnë si bijën e tyre, duke i dhënë Titullin “Mbretëresha e Malevet Shqiptare”.

Kjo për faktin se ajo njohu nga afër dhe ka pasur letër këmbime me shumë prej personaliteteve të shquara të vëndit tonë, si me Ismail Qemalin, Kristo Dakon, Dervish Himën, Mit’hat Frashërin, Pandeli Evangjelin, Faik Konicën, Lef Nosin, Mehmet Konicën, motrat Qiriazzi, Aqif Pash Elbasanin, Hil Mosin, Hoxhë Kadrinë, Bajram Currin etj. Për të gjitha këto ajo ka zënë vëndin e merituar në historinë e Shqipërisë.

Fotoekspozita është e lëvizshme do ekspozohet dhe në qytete të tjera të vëndit tonë.



## REÇENSA

# SOLLZHENJICINI, SHKRIMTARI QË I DEMASKOË MË SHUMË SE KUSHDO KRIMET KOMUNISTE

SHPENDI TOPOLLAJ

**M**ë ndodh të vras mendjen e të gjej se çfarë e bashkon dhe çfarë e ndan krijimtarinë e Dante Aligerit nga ajo e Aleksandër Sollzhenjicini. Thjeshtë se ata ishin njëri italian e tjetri rus, apo se njëri kishte jetuar nja shtatë shekuj më parë e tjetri në kohë moderne. Të dy shkruan për Ferrin; i pari për atë imagjinarin, i dyti për atë të vërtetin. I pari për vuajtje fajtorësh dhe i dyti për vuajtje të pa merituar e të padrejta. I pari askund nuk thotë se bashkë me të dënuarin në Ferr e pësonin edhe të tjerët, miq, shokë dhe të afërm, kurse i dyti përshkruan edhe vuajtjet e bashkëshortëve, fëmijëve e kushërinjve kur e pësonte dikush. I pari nuk bën fjalë askund për shejtanllëkun e ridënimeve, kurse i dyti shpjegon se ato qenë mëse normale, si me të burgosurit ashtu edhe me të internuarit.


I pari nuk na jep asnjë rast ku dikush të ishte dënuar vetëm pse kishte shkruar një letër ku aludonte për ndonjë udhëheqës, kurse i dyti e kishte pësuar vetë ngaqë në një letër që i dërgonte një mik, fliste ashtu si shkarazi për atë të madhin fare, Stalinin. I pari në traktatin e tij "Monarkia" kërkon te ndarjen e kishës nga shteti, kurse i dyti e dinte se këtë punë e kishte kryer shteti vetë, madje edhe më dhunshëm, duke e bërë të paqenë atë. I pari përshkruan kundërshtitë që kishin dy partitë, Guelfët e Gibelinët, kurse i dyti, na jep luftën që bëhej brenda të njëjtës parti, asaj bolshevikes...

Të dy u përfshinë në luftë; i pari në betejën e Kampalinos dhe i dyti si kapiten i Ushtrisë së Kuqe, kur ushtria hitleriane sulmoi vendin e tij. Njëri zgjodhi për të na i dhënë ato që donte me vargje e tjetri në prozë. Dhe çfarë i bashkon ata?

Së pari vetëdija atdhetare dhe instinkti i drejtësisë. Pastaj stigmata e mos pajtimi me të keqen, vlerësimi për virtytet njerëzore, nderimi për ndershmërinë, guximin, besnikërinë e mos nënshtrimin dhe fati i tyre i njëllotë. I njëllotë, pasi edhe Dantja u përzu nga vendi i tij dhe jetoi në disa vende, për të vdekur në Ravena, por edhe Sollzhenjicini në vitin 1974 u përzu nga Bashkimi Sovjetik, për të jetuar për shumë vite, fillimisht në Gjermani, Zvicër e pastaj në Kaven-dish të Vermontit në SH. B. A. për 18 vjet.

Dhe të dy u kurorëzuan; i pari me një kurorë dafinash dhe i dyti me çmimin "Nobel" në vitin 1970. Tani le ta gjejë vetë lexuesi se cili Ferr që më i tmerrshmi. Por nuk e kisha fjalën këtu; desha të them që shihni si përsëriten historitë, por shihni gjithashtu se si kthehen shkrimtarët e vërtetë në shenjtorë që i duhen çdo kohe. Ai u lind në Kislovodsk më 11 dhjetor 1918, dhe studimet e larta i kreu për matematikë e fizikë në Rostov. Por vazhdoi edhe disa kurse filozofie dhe letërsie. Në rininë e tij jetoi arbitraritetin dhe goditjet që diktatura staliniste u bënte intelektualëve. Por aso kohe, ose nuk i dinte ose nuk donte t'i besonte.

Pas 22 qershorit të vitit 1941, kur tinëzisht Hitleri sulmoi Bashkimin Sov-



jetik, ai u fut në radhët e ushtrisë, ku mori dhe gradën kapiten. Mirëpo pas fitores mbi fashizmin, nisi të ndërrojë për "lumturinë" që sistemi komunist po i sillte popullit rus. Ndaj dhe ndodhi ajo historia e asaj letrës ku ai tallte "babain e popujve të botës" J. V. Stalinin. Gjyqi nuk deshi t'j dinte për qëndrimin e tij të më parshëm dhe gjatë luftës, dhe e dënoi me tetë vjet burg e më pas me tre vjet internim. Këto qenë vitet e llahtarshme, ku ai jo vetëm vuajti vetë, por pa edhe sesi u ishte shkatërruar jeta një pafundësie njerëzish të pafajshëm.

Askush nuk mund të fliste për gjendjen në ato kampet e punës që zunë t'i quanin Gulakë (Drejtoria shtetërore e kampeve të riedukimit të punës). Kur në 5 mars të vitit 1953, gjeneralisimi Stalin u gjet i lagur në një divan të daçës së tij, dhe pasi ndodhën ato ngjarjet e njohura të luftës për pushtet, që u finalizuar me pushkatimin e kriminelit georgjian Lavrenti Pavloviç Beria, dhe ardhjen në krye të Komitetit Qendror të N.S. Hrushovit, situata nisi të zbutej. Pati një farë ndyshimi, ndaj dhe Sollzhenjicini, si për të demaskuar krimet e Stalinin me shokë, shkruan librin "Një ditë e Ivan Denisoviçit".

Pati reaksion, deri dhe përpjekje për të mos e botuar, nga zyrtarë e partiakë, por u desh ndërhyrja e vetë Hrushovit që në vitin 1962 ai të dilte në dritë, duke u botuar nga "Novij Mir". Lajmi i botimit të tij mori dhenë; kudo kërkohet ai, dhe perëndimi e priti me ngazëllim. Ishte dëshmia më autentike e llahtarëve që hoqën njerëzit në atë vend me propagandë mashtruese, ishte akt akuza më bindëse dhe e vërteta e pakundërshtueshme që do t'i hapte sytë gjithë atij populli të madh. Emri i personazhit, Shuhov, u bë kudo i njohur, ashtu sikurse gjithkush pa gjithësa ai dhe të dënuarit e tjerë, hoqën dhe u përpoqën për të mbijetuar. Luftë me punën e rëndë të detyruar, luftë me të ftohtit e jashtëzakonshëm, luftë me urinë e përherëshme, luftë me çnjerzillëkun e rojave, ndeshjet me kriminelë të çfarëdollojshëm, luftë me ndërgegjen e tyre... Ja dhe ironia e paharruar në mbyllje të këtij libri: "Kishte kaluar edhe një ditë pa brenga, pothuajse e lumtur.

Ditë të tilla gjatë dënimit të tij nga mëngjesi në mëngjes kishte pasur tremijëgjatëqindpesëdhjetëtri. Për shkak të viteve të brishta i rezultuan edhe tri ditë të tepërta...". Dhe çuditërisht, në asgjë nuk ndryshon shtypja, hakmarrja, shpërfillja e jetës, shkaktimi i dhimbjeve, hapja e plagëve, krijimi i dramave shpirtërore të atij vendi prej nga e morën komunizmin, edhe Enver Hoxha me bandën e tij, dhe na e bënë peshqesh në Shqipëri. Lexoni At Zef Pllumin, Uran Kalakullën, Pjetër Arbnorin, Visar Zhitin etj. etj. dhe do të shihni se sa Shuhova ka pasur këtu te ne. Por kur u pa se bota po e vlerësonte aq lart këtë shkrimtar, aqsa edhe akorduan në vitin 1970 çmimin më të madh "Nobel", qëndrimi ndaj tij ndryshoi kryekëput.

Kishte ardhur në fuqi Brezhnjevi, dhe ai nuk të falte për këto punë, ndaj Aleksandër Sollzhenjicini që e donte bota, e shpallin të padëshiruar në vendin e tij. Kështu i qenë turrur edhe Boris Pasternakut dikur, kur shkroi "Doktor Zhivago". Por Sollzhenjicini, vazhdon të krijojë dhe boton librin voluminoz "Arkipelagu Gulak", një libër demaskues dhe i mbushur me fakte rrëqethëse nga dëshmitë e 227 të dënuarve, dhe që shkrimtari ua kushton "të gjithë atyre që nuk u mjaftoi jeta për të rrëfyer dhe të më falin që nuk i pashë, që nuk i përmenda dhe që nuk i mora dot me mend të gjitha". Dhe sikurse sqaron më tutje ai: "Në këtë libër nuk ka as personazhe të trilluar. Njerëzit dhe vendet përmenden me emrat e tyre të vërtetë. Nëse përmenden me iniciale, kjo bëhet për arsye personale. Nëse nuk përmenden fare, kjo ndodh vetëm për arsye se kujtesa njerëzore nuk i ka ruajtur emrat... Por gjithçka ka ndodhur pikërisht kështu". Në këtë libër ka perla përshkrimesh nga sa ngjanë në atë vend. Të gjitha nuk të shlyhen nga kujtesa, por dua të theksoj analizën e zgjuar që ky shkrimtari i bën dënimit si tradhtar të atyre djemve të Rusisë që ranë rob në dorën e gjermanëve: "Pra, çfarë rruge duhej të ndiqnin robërit rusë të luftës? Ligji ishte vetëm një; të shtrihesh dhe të lejoje të të shkelnin. Çdo fije e hollë bari çan tokën për të jetuar, kurse ti duhej të shtrihesh... të të shkelnin.

Ndonëse me vonesë... vdis në këtë moment, përderisa nuk vdiqë në fushën e luftës, sepse vetëm atëherë nuk do të gjykohej". Kurse për të shkruar romanin - epope "Gushti i katërmëdhjetës - "Rrota e kuqe", u deshën plot njëzet vjet (1971 - 1991). Ai kishte nisur në fakt, qysh nga viti 1937.

M'i solli të dy volumet e këtij romani me mbi 1.200 faqe, njeriu i mirë dhe përkthyesi i talentuar dhe plot kulturë, shoku im historiani Nikolla Sudar. E lexova atë, dhe dashje pa dashje e krahasova me fuqinë e "Lufta e Paqja" e Tolstoit. Një enciklopedi e atyre ngjarjeve që zhvillohen në prelude dhe një shndërrimi të madh politik, social dhe ekonomik të Rusisë. "Pavioni i kancerozëve", po ashtu i përkthyer nga Nikolla, me ngjarje të vërteta nga ai spitali i Tashkentit që ai kishte vizituar, mbetet një vepër artistikisht mjaft e arrirë nga ky autor të cilit i është botuar kolana e veprave të tij në tri-dhjetë volume. Ish rreshteri Oleg Kostoglotov, Aleksei Shulubini, Rusanovi, Vadim Zacirko, Efrem Podujevi, Diomka dhe djali i sëmurë nga këmba, me gjithë qëndrimet shpesh të ndryshme, të dhimbshen aq shumë, sa mezi pret ta mësosh fatin e tyre të mëtejshëm. Sa i mrekullueshëm mbetet rrëfimi i Shulubinit në bisedë me Kostoglotovin, për rastin e Dima Olinckit që kishte abstenuar për pushkatimet, duke shtuar se: "Unë besoj se në vitin e dymbëdhjetë të revolucionit duhet të jemi në gjendje të gjejmë mënyra alternative të luftës së klasave". Dhe kaq u desh. Pasuan thirrjet: "Maskarai! Agjent i armikut!" Kur shkrimtari i madh më në fund u kthye në atdhe, me rastin e ditëlindjes së tij të tetëdhjetë, reformatori Boris Jelcin e dekoroi me urdhërin "Apostull i shenjtë Andrej Përvoznani", por ai dinjitoz siç ishte, madje dhe mjaft kritik ndaj të metave, sikurse kishte qenë edhe atje në Amerikë, e refuzoi atë dekoratë, me arsyetimin: "nuk mund të pranoj urdhrin nga udhëheqja e lartë, e cila e ka shpënë Rusinë në këtë gjendje katastrofike". Thashë dinjitoze, por si shqiptar nuk mund të mos kem dhe qortimin tim për të; kur bota mbarë pa krimet e përbindshme të kasapit Slobodan Millosheviç ndaj popullit paqësor kosovar, kur krimet e tij dhe falangave që ai lëshoi ndaj njerëzve të paarmatosur, grave, pleqve e deri fëmijëve, Aleksandër Sollzhenjicini nuk e prezantoi veten aspak mirë. Ai mbajti anën e agresorëve sllavë, duke gabuar rëndë dhe duke harruar se nuk i takonte atij t'u mbante ison kriminelëve, nga çdo anë që ata mund të vinin. Vdiq në Moskë më 3 gusht 2008, në moshën gati nëntëdhjetë vjeçare. Vlen të citohet kritiku D'Orrico i cili duke folur për veprën e tij ka thënë: "Ka qenë ky shkrimtar rus që thajse i vetëm rrëzoi socializmin real, e madje edhe gjithë filozofinë nga frymëzohej ky sistem. Ishte një ndërmarrje titanike. Ndoshta e keni pyetur ndonjëherë veten se për çfarë na duhet letërsia. Ja ku po u them, letërsia në disa raste mund të shërbejë pikërisht për këtë arsye, të shembë një regjim, një perandori".

## SUPLEMENTI LETRAT

Poet me vokacion të plotë që i këndon me një sinqeritet befasues ëndrrës njerëzore

# KADRI TARELLI, VETERAN I FJALËS

## MEVLUD BUCI

**K**rijimtaria e Kadri Tarellit spikat me artikujt e tij publicistikë, të kritës letrare dhe të poezisë.

Lirikat e tij janë të larmishme, plot ngrohtësi dhe dashuri për njerëzit. Midis lirikave të Kadriut do të gjejmë edhe fabula interesante të cilat të bëjnë për vete me mendimin e mprehtë. Këto përshtypje m'u krijuan ndërsa lexoja librin e tij të fundit me poezi "Vjeshta në Vargje", një botim i përkorë me lirika të bukura plot ndjesi dhe vërtetësi.

Duhet thënë se Kadri Tarelli është poet me vokacion njerëzor të plotë ku ai i këndon me një sinqeritet befasues ëndrrës njerëzore dhe besimit se kjo ëndërr ndodhet tek çdo njeri dhe që duhet ndjerë e besuar si e tillë kur e shikon të sendërtuar në marrëdhënie midis njerëzve, në fjalët, sjelljet gjykimet e tij.

Është meritë e autorit që në çdo poezi, sipër saj ka vënë nga një sentencë nga autorë të njohur dhe të duket se poezia më poshtë është zëbërthim i saj, por nuk ndodh kështu ndërsa lexon poezinë Poezia vjen si bashkëshoqërim, si paralele e sentencës më lart, vjen si frymë me një mendim të thukët.

*"Për typ fjalët nëpër dhëmbë,  
Durrësi im ngjyer në gri;  
Pse m'i lidh duar dhe këmbë,  
Nuk jam plak, kam gjak të ri..."*

Poeti është nga Devolli, por Durrësi është vendlindja e tij e dytë. Marrëdhëniet shpirtërore me këtë qytet duken gjithandej, te njerëzit, e sidomos te peizazhet e këtij qyteti të mrekullueshëm bregdetar. Këto marrëdhënie shprehen me detin, qytetin e lashtë, rrugët e rrugicat ku autori me penelin e shpirtit vizaton pamje intime plot bukuri dhe finesë.

*"Më ngazëllen vala tërbuar,  
Dal në breg e do të pres,  
Jam durrsak i qetë i shtruar,  
Miqte e vjetër përshëndes..."*

Vargje të tilla dhe të tjera të kësaj natyre vërshojnë me një temporitëm tërheqës plot ndjesi dhe vërtetësi të ndjenjës ku përshkruhet jeta dhe



uni poetik i autorit vendoset me një vetëbesim dhe dashuri midis njerëzve. Në poezitë e Tarellit peizazhi merr një vlerë të veçantë dhe poeti është njohës i tij, njohës deri në detaje. Këto element të peizazhit ai i merr i transfiguron, i përthith dhe i shtrin në indet e një poezie lirike dhe ndiesore.

*"Era tund balluket si kallinj të e grurit,  
Fustanin me lule mbi kupë të gjurit..."*  
Ose:  
*"Vija-vija deti i ndarë,  
Pasyrë thyer veshur në gri..."*

Elementë të tillë të peizazhit mund të gjejmë në tërësinë e vëllimit të Tarellit të cilat tregojnë se poeti është një vizatues i hollë i peizazhit dhe i gjendjeve të caktuara shpirtërore të cilat inter-

- *Si veteran i fjalës Kadri Tarelli (njëherësh nënkryetar i Degës OBVL P Durrës) është një njohës i sprovuar i saj. Kjo se ai ka kohë që merret me fjalën në mënyrë intensive. Ai është poet i motiveve të llojllojshme nga ato të thjeshtat që inspirohen nga përditshmëria e njeriut deri tek socialet apo ato kombëtare*

ferojnë përmes mendimeve të shumta të poetit dhe krijojnë hapësira për ide të reja e këndvështrime të shumta me thekse ngjyrues emocionalë.

Aty këtu spikat ndonjë lirikë dashurie ku autori e vizaton portretin e femrës në një gjendje fisnike:

*"Ngjyra jote fton sytë e bletës,  
Mbi petale buza të ulet ;  
Unë e hap portën e jetës,  
Përmbi buzë buza të ngulet..."*

Si veteran i fjalës Kadri Tarelli (njëherësh nënkryetar i Degës OBVL P Durrës) është një njohës i sprovuar i saj. Kjo se ai ka kohë që merret me fjalën në mënyrë intensive. Ai është poet i motiveve të llojllojshme nga ato të thjeshtat që inspirohen nga përditshmëria e njeriut deri tek socialet apo ato kombëtare. Këto motive ai i trajton me një varg të rrjedhshëm plot ëmbëlsi e me kadenca të rregullta të mbështetura ndonjëherë në folklore me një bukuri të veçantë.

## DALI NDREU, komandant i njësive të mëdha strategjike

(Vijon nga faqja 5)

Shtabit të Përgjithshëm. Ai ishte një ndër bashkëpunëtorët kryesorë të komandës së këtij shtabi.

Me kalimin e ushtrisë partizane në ushtri të rregullt, pas Kongresit të Përmetit, u bë komandanti i parë i Divizionit të Parë Sulmues që në krijim dhe më tej u bë dhe komandanti i parë i Korparmatës së Parë. Ky ishte Dali Ndreu. Ai dha një kontribut të shquar dhe të veçantë në drejtimin e operacioneve të përmasave operative-strategjike që kryen njësitë e mëdha të UNÇSH-së. Ai kontribuoi në përgatitjen dhe zhvillimin e mësymjes së përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit, në mënyrë të veçantë për çlirimin e Kryeqytetit dhe të qytetit të fundit të Shqipërisë, të Shkodrës.

Emërimi i Dali Ndreut në këto funksione të larta ushtarake, mbante parasysh jo vetëm përvojën dhe aftësitë e tij ushtarake e komanduese, por dhe simpatinë e autoritetin që gëzonte në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të

Veriut.

Janë këto merita, dhe puna e tij shembullore dhe e palodhur për çështjen kombëtare që në gusht 1944, në moshën 32 vjeçare të gradohet me gradën ushtarake "gjeneralmajor".

Akademia përkujtimore për nder të gjeneralit të luftës, në kuadrin e 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut, i bën nder jo vetëm veteranëve dhe Lidhjes Intelektuale Dibrane, por të gjithë shqiptarëve. Dali Ndreu e meriton vlerësimin "Nderi i Kombit", pasi u luftë u gjend komandant i njësive të mëdha operative-strategjike dhe në ndërtimin e vendit në krye të punëve të mëdha. Populli shqiptar në këtë 80 vjetor të çlirimit kujton dhe nderon një nga luftëtarët e mëdhenj që kontribuan madhërisht dhe fituan mbi pushtuesin nazifashist, gjeneralin dhe anëtarin e Shtabit të Përgjithshëm Dali Ndreu.

## SUPLEMENTI LETRAT

# FAJI ËSHTË I URDHËRUESIT TË LUFTRAVE

Tregim nga Sakip Cami

**D**rini, ishte lumi shekullor me të cilin këto banorë kishin lidhur jetën. Fshati Visiart shtrihet midis lumit të Drinit të Zi dhe Zallit të Mullkastrës, një shtrirje malore me kodra të shumta e të rrumbullakta, me përrenj e gjirize[1] të shumtë. Ky fshat kishte katër lagje, Visiart i poshtëm, Visiart i sipërm, Goldvis dhe Burim. Kjo e bënte që përhapja e tij të ishte shumë e madhe në raport me numrin e banorëve. Por kjo ishte gjithë e mirë sepse çdo banori i takonte pak fushë, pak mal, pak lumë, pak pyll, pak djerrishtë, pak lajthishtë dhe shumë pemë e perime, shumë të ardhura nga natyra e begatë. Jo më kot nuk i thonin Visiart. Dyndjet sllave në shekullin e gjashtë deri në shekullin e dymbëdhjetë nuk ja ndryshuan dot as emrin. Defterët e vjetër shënonin emra të tjerë, ndërsa banorët e thërrisnin ashtu bukur, shqip, Visiart. Lagjen e Burimit, që për çudi ishte në një majë kodre sepse atje kishte buruar uji, sllavët e kishin quajtur Izvor, ndërsa banorët vendas Burim. Disa banorëve të kësaj



lagje u mbeti mbiemri Izvira, por jo Izvori. Izvira u dukej më shqip, më dibrançe. Goldvis ishte fshat e kaluar fshatit, por administrativisht varej nga Visiarti dhe mbeti në juridiksionin e një lagjeje. E çfarë nuk kishte në këtë fshatlagje! Me shtëpitë përballë lindjes së Diellit, fshatarët merrnin dy prodhime. Prodhimin e

parë në perime dhe prodhimin e dytë në grurë e thekër. Në këtë fshat ishin të gjitha varietetet e mollëve, të dardhave, kumbullave, rrushit, arrave, gështenjave, lajthive si dhe pemëve të rralla.

Fshati ndahej nga dy fshatrat e tjerë; Gjurišta dhe Mirasi, nga dy kodra të buta që ngriheshin në të majtë të rrjedhës së lumit të Drinit të Zi. Lugina e Drinit ishte pjesë e lagjes së Visiartit të Poshtëm. Vërshimet e Drinit ishin të fuqishme në dimër, por për çudi sa arrinin në Visiartin e Poshtëm, aty sikur zbuteshin derisa arrinin të bëheshin pjesë e jetës së banorëve. Banorët prej tyre shpesh merrnin humus e drurë për t'i përdorur për nevojat e tyre të përditëshme. Lumi i Drinit u ofronte edhe peshkun e veçantë të troftës që banorët i thonin pikakuq sepse kishte disa pika të kuqe të arta. Përveç pikakuqit, musteqari ishte peshku më i mirë i lumit. Kur rriheshin[2] peshqit, banorët e dinin kohën dhe kujdeseshin që askush të mos i trazonte. Në sezonin e verës fillonte verimi, larja në lumë, zhytja në hurdhë, ngrohja në rërën e imët dhe gjuetia për peshkatarët. Peshkatarët ishin zanatalinj. Ata kufizonin vaun me gurë dhe ndërtonin vanakun me gjethe shelgu. Në fund të gurëve bënin një grykë të vogël ku grumbullohej peshku dhe aty vendosej një kosh me thupra shelgu. Peshku trazohej me vanakun e shtyrë nga peshkatarët dhe fëmijët e

tyre dhe në fund përfundonte në kosh. Ky ishte gëzim i papërshekruar, si për interesin për ushqim, ashtu edhe për sportin e gjuetisë. Me rërën e imët banorët ndërtonin dhe suvatonin shtëpitë. Në të majtë të Goldvisit ishte përroi me të njëjtin emrin. Në të djathtë ishte përroi i Visiartit. Ky përroi ishte në mes të Visiartit dhe Goldvisit, prandaj që të dy lagjet e kërkonin pronësinë dhe emrin e përroit. Në krye të fshatit Goldvis ishte një kodër rrumbullake e veshur me shkurre e dru lisi që i thonin kodrishtë. Poshtë saj ishte Livadhi i Ristos me kroin në krye të tij. Përroi i Mitros ishte një përroi i vogël, i cili emrin e kishte marrë nga një ushtar sllav që ishte vrarë aty. Banorët nuk ishin lodhur që t'ja ndryshonin emrin se u kujtonte Mitron që e kishin vrarë sepse u preku pyllin e tyre të shenjtë. Edhe Ara e Bllazhos ishte në krye të Livadhit të Ristos. Megjithëse Bllazho e kishte hapur vetë me krahë këtë arë të vogël në mal, përsëri nuk preferonin të ja thonin emrin. Edhe varret sllave të rrënojat e kishës, shekuj më parë, banorët e Goldvisit nuk i shkatërruan. Njeriu është rob i Zotit. Faji është i urdhëruesit të luftërave.

Si një kapele mbi kokë të fshatit qëndron Zabeli i Madh dhe Guri i Shalës. Guri i Shalës ishte me të vërtetë një gur mahnitës, tamam si një shalë kali. Thuhej se këtu një kalorësi pushtues i mbeti shalla dhe shalla ngriu e u bë gur.

Guri i Shalës ishte një monument që ruhej nga banorët. Livadhet e gjata me burimin mbi krye ishin një tjetër mrekulli natyrore e këtij fshati me vise të arta. Si një ombrellë e blertë ishin pemët dhe lisat që banorët u thonin çadtrat e Izvirës. Monument natyror i krijuar nga vetë natyra. Më tej Livadhi i Cen Kullës. Nuk dihej nëse Ceni e mori emrin nga kulla që ndërtoi në fund të livadhit apo jo sepse fis Kulla nuk kishte patur në këtë fshat ndër shekuj. Nuk ja prishi as pamjen, as begatinë livadhit Ceni. Kullën e ndërtoi në fund të tij, pranë burimit të ujit dhe e shfrytëzoi livadhin për bar e thekër. Edhe patatet bëheshin sa një kokë njeriu se dheu ishte i lehtë dhe uji i burimit buroi për njerëzit, kafshët e egra, kafshët e buta dhe bimësinë e shumtë. Po të varesh poshtë Livadhit të Cen Kullës do të shkoje në Zallin e Mullkastrës, që derdhej në Drinin e Zi. Po Lajthiza?! Me ujin e lehtë dhe të ftohtë që buronte prej saj shëronte çdo sëmundje të aparatit tretës të njeriut. Banorët i thonin ujë i bekuar. E pra këtë fshat të begatë dhe këtë lumë të bekuar donin t'ua merrnin shqiptarëve, dibranëve, banorëve të Visiartit. Banorët thonin se donte ta merrte shqijau, serbi. Disa më të shkolluar thonin se kështu kanë vendosur Fuqitë e Mëdha. Dhimbjen për Drinin nuk mund t'a duronin. Drini ishte ishte fati i tyre. Drini u bë mollë sherri për shtetet dhe Fuqitë e Mëdha sepse vendosën që ai të shërbente si kufi shtetëror. Kjo ishte fatkeqësi e madhe. Që nga ky moment askush nuk kishte më të drejtë të lahej në lumin e tyre, të gjuante peshk, të merrte rërë, të punonte tokën. Nga padronë të tokës së tyre, të lumit të tyre, banorët e Visiartit tani po kthehen në skllevër të padrejtësisë.

-Kjo nuk durohet burra, tha Shaban Cami. Shtëpinë në Gjoricë ma dogji turku se dolëm në luftë kundër Turqisë e Hajredin Pashës, por ne ndërtoam tre kulla të reja, një në Visiartin e sipërm, një në Goldvis dhe një në Miras. Tash duan të na djegin dhe të na zbojmë edhe nga këto troje që të parët tanë na i kanë lanë, por kjo nuk ka për të ndodhur, sepse do t'i mbrojmë me gjakun dhe jetën tonë. Lajmëro burrat e fisit e të krejt fshatit e bëhuni gati për luftë! urdhëroi Shabani.



FOTOREPORTAZH

# 2024 – OBVL REKORD VEPRIMTARISH KUALITATIVE


Gjatë vitit që mbyllet këtë fund dhjetori, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve përmbylli me sukses programin e veprimtarive, ku më të rëndësishmet qenë:

- AKADEMIJA PËRKUJTIMORE: “HEROI I POPULLIT DHE NDERI I KOMBIT RRAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË”
- KREMTIMI I 30 VJETORIT TË OBVL dhe botimi i librit “30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI”
- KUVENDI I 9-të KOMBËTAR I OBVL qe zgjodhi kryetare Znj. Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu...

Dhe

- AKADEMIJA PËRKUJTIMORE: “Gjeneral Dali Ndreu, strategu që drejtoi luftën për çlirimin e Tiranës.

Këto veprimtari të nivelit akademik, të shoquara me dokumentarë televizivë, me referate e kumtesa të qënësishme, të përgatitura dhe mbajtura nga personalitete të njohura të shkencës dhe letrave, u ndoqën me interes të veçantë nga veteranë të LANÇ dhe pasardhës-anëtarë të OBVL, si dhe nga dhjetra të ftuar nga ogranizatrat homologe.



(Fotot nga FEHMI LLESHI)